



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1890 Prot.

Tiranë, më 24.12.2021

Lënda : Përcjellje e Vendimit të Senatit Akademik “Për miratimin e Raportit Vjetor të Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin 2021”

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Në zbatim të nenit 30, të pikës 1/i të nenit 38, të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimit nr.5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019; bashkëngjitur kësaj shkrese, Senati Akademik ju përcjell Vendimin nr.140, datë 20.12.2021 “Për miratimin e Raportit Vjetor të Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin 2021”.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1848 Prot.

Tiranë, më 20.12.2021

VENDIM

Nr. 140, datë 20.12.2021

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR
TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PËR VITIN 2021

Në zbatim të nenit 30, të pikës 1/i të nenit 38, të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimit nr.5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.12.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit Vjetor të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore, si dhe ekonomiko-financiare për vitin 2021 të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Ky Vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për miratimin përfundimtar.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

**RAPORT VJETOR
PËR
VEPRIMTARINË
VITI AKADEMIK
2020-2021**

Tiranë, Dhjetor 2021

PASQYRA E LËNDËS

- I.** Hyrje
- II.** Përmbledhje ekzekutive e raportit
- III.** Të dhëna të përgjithshme për UST-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse
- IV.** Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit
- V.** Informacion për bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë UST
- VI.** Informacion për kërkimin shkencor
- VII.** Informacion për programet e studimit që ofron UST
- VIII.** Ndryshimet në bazën rregullatore të UST-së
- IX.** Informacion për angazhimin e personelit akademik
- X.** Informacion për veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- XI.** Informacion për studentët
- XII.** Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore
- XIII.** Të dhëna për planin buxhetor
- XIV.** Vlerësime dhe rekomandime të UST-së për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit

I. HYRJE

UST është një institucion publik, jofitimprurës i arsimit të lartë në Shqipëri që spikat për vlerat që transmeton dhe aftësimin praktik të të diplomuarve për botën e punës.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është i vetmi institucion i lartë publik i këtij lloji në Republikën e Shqipërisë në funksion të përgatitjes së mësuesve të edukimit fizik e shëndetësor, specialistëve të sportit, fitnesit dhe aktivitetit fizik për shëndet si dhe menaxherëve të sportit e turizmit si dhe specialistë të fushës së rehabilitimit. Universiteti realizon kualifikimin e plotë shkencor të specialistëve të edukimit fizik e shëndetësor, të sporteve, të rekreacionit e turizmit të aventurës si dhe të rehabilitimit fizik e shëndetësor, duke përmbyllur të tre ciklet e studimit në këto fusha e nënfusha.

Fillesat e Universitetit të Sporteve të Tiranës nisin që në vitin 1948, si e para shkollë që përgatiste mësuesit e ardhshëm të edukimit fizik. 10 vjet më vonë, pas krijimit të Universitetit të Tiranës, u krijua dega e fiskulturës pranë Fakultetit të Histori-Filologjisë. Më vonë, kjo degë u kthye në fakultet me drejtimin “Mësues i Edukimit Fizik dhe Edukim Shëndetësor”.

Dy vjet më vonë, në vitin 1960, krijohet Instituti i Fiskulturës si institucion me vehte i arsimit të lartë.

Në vitin 1962 pranë këtij institucioni, u ngrit Qendra Kërkimore Shkencore. Kjo qendër do të ndihmonte në evidentimin dhe përpunimin e mendimit bashkëkohor shkencor në fushën e edukimit fizik dhe sporteve si dhe do të vijonte të jepte një kontribut të çmuar edhe në hartimin e politikave zhvillimore të institucionit për të ardhmen.

Duke filluar nga viti 1966 struktura e këtij institucioni ka funksionuar mbi bazën e katedrave universitare si njësi bazë mësimore e kërkimore-shkencore, dhe prej vitit 1994 mbi bazën e departamenteve.

Në vitin 1993 institucioni mori statusin e një Akademie të Edukimit Fizik dhe Sporteve e shtatë vite më vonë, në vitin 2010, pas zgjerimit të aktivitetit akademik e strukturor, ky institucion fitoi statusin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), ky institucion që ne jemi sot, që ka në përbërjen e tij tre fakultete dhe një institut të kërkimit shkencor në sport.

Nga krijimi i tij e deri më sot, Universiteti i Sporteve të Tiranës, duke qënë institucion i vetëm publik në vendin tonë që ofron të treja ciklet e studimit në fushat e përmendura më sipër, ka diplomuar në mënyrë sistematike mësues, trajnerë dhe specialistë të lartë të fushës së edukimit fizik, sportit, fitnesit e rekreacionit, menaxhimit të aktiviteteve dhe njësisive sportive, menaxhimit të turizmit të aventurës si dhe rehabilitimit fizik të sportistëve por edhe më gjerë.

Sot, në Universitetin e Sporteve të Tiranës studiojnë në të gjitha ciklet e studimit rreth 1.500 studentë të cilët janë pjesë përkatësisht e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (FSHL), i cili përgatit Mësues të Edukimit Fizik dhe Shëndetësor, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR), i cili përgatit Trajnerë Fitnesi dhe Menaxherë të Sportit e Turizmit, dhe të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit (FSHR) që përgatit Specialistë të Rehabilitimit. Një kontribut

shumë të rëndësishëm jep Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit (IKSHS) me studimet e tij, të cilat kanë rëndësi jo vetëm për institucionin, por edhe më gjerë.

UST është një institucion i akredituar dhe së fundmi ka kaluar procesin e riakreditimit me ekspertë të huaj të fushës nga Gjermania dhe UK ku në raportin final të lëshuar nga to ka marrë vlerësimin maksimal në të gjithë komponentët akademik e shkencore. Ky Institucion gëzon një reputacion të shkëlqyer si në Shqipëri ashtu edhe në rajon e më gjerë. UST ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë universitete të rajonit dhe universitete evropiane, dhe është partner në disa projekte të rëndësishme evropiane.

Studimet në UST janë organizuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e tjera nënligjore. UST ofron aktualisht të tre ciklet e studimit, ku fokusi kryesor janë programet e studimit të orientuara tërësisht në fushën e sporteve, të edukimit fizik, rekreacionit, turizmit të aventurës dhe rehabilitimit, duke siguruar që të diplomuarit në UST, nëpërmjet aftësive akademike, kërkimore-shkencore, aplikative, analitike dhe profesionale që marrin, të angazhohen në mbulimin e shërbimeve në fushat e sipërpërmendura. Të diplomuarit në UST, në të gjitha programet e ciklet me statistikën e ndjekura nga Sektori i Karrierës, Alumnit dhe Marrëdhënies me Studentët, punësohen sipas fushës së tyre të studimit brenda një afati 3 vjeçar në 98% të tyre, gjë që tregon efektivitetin dhe besimin që ka tregu për të diplomuarit pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës.

UST ofron programe studimi të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë. Të gjitha programet e studimit aktive janë akredituar në përputhje me legjislacionin në fuqi përveç programit të ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit. Dy programe studimi të ciklit të tretë janë hapur në vitin akademik 2021-2022. UST ofron programe studimi në përputhje me tendencat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar.

UST ka një mision të përcaktuar qartë për të përmbushur nevojat e arsimit të lartë dhe të ekonomisë shqiptare në fushën e edukimit fizik e shëndetësor, zhvillimin e mëtejshëm të sportistëve elitare, formimin dhe zhvillimin e sporteve dhe veprimtarive rekreacionale, turizmin aktiv dhe atë të aventurës, specialistë të shëndetit dhe mirëqënies fizike, specialitë të fushës së shkencave rehabilituese si dhe specialistë të fushës së kërkimeve shkencore në të gjitha aspektet e dimensionet të përshkruara më lart.

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka zhvilluar strukturat e duhura të qeverisjes dhe kapacitetin e menaxhimit për të mbështetur një popullatë prej rreth 1500-2000 studentësh të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Aftësimi i studentëve për punë është mundësuar nëpërmjet praktikave dhe punëdhënësit kanë vlerësime pozitive për njohuritë dhe aftësitë që kanë studentët dhe të diplomuarit e Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe çfare ata sjellin në vendin e punës.

Sfida e madhe është që Universiteti i Sporteve të Tiranës të zhvillohet si një qendër moderne të të mësuarit dhe kulturës, si një institucion i standardeve dhe njohjes ndërkombëtare.

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E RAPORTIT

Universiteti i Sporteve të Tiranës paraqet raportin për veprimtarinë e kryer gjatë vitit akademik 2020-2021.

Raporti është hartuar sipas Udhëzimit të MASR Nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor”, i ndryshuar me Udhëzimin e MASR Nr. 24, datë 21.10.2019.

Raporti përmban:

1. informacion të përmbledhur për veprimtarinë e Universiteti i Sporteve të Tiranës në përmbushje të misionit të tij, duke u përqendruar në arritjet, sfidat dhe rrugëzgjdhjet për to si dhe në synimet për të ardhmen;
2. informacionin e kërkuar nga MAS, sipas strukturës së përfshirë në udhëzimin përkatës;
3. informacion për veprimtarinë e Universitetit të Sporteve të Tiranës për komunitetin e këtij institucioni dhe për të gjithë të interesuarit;
4. mendime dhe rekomandime për bashkëpunimin me MAS.

Raporti vjetor për veprimtarinë e Universitetit të Sporteve të Tiranës është hartuar, bazuar në veprimtarinë e organeve drejtuese të institucionit, të njësive kryesore, të njësive bazë, të administratës, të studentëve. Raportet e njësive kryesore, raporti i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, raporti financiar i institucionit si dhe raportet e ASCAL për riakreditimin e programeve të studimit si dhe atë institucional janë burimet kryesore për hartimin e këtij raporti.

Ky raport shërben edhe si një raport vetëvlerësimi dhe përcakton masat që duhen marrë për përmirësimet e nevojshme për vitin e ardhshëm akademik.

Arritje

Aktiviteti i UST-së, gjatë vitit akademik 2020-2021 është realizuar në përputhje me *Planin Strategjik të Zhvillimit për periudhën 2020-2026* dhe janë shënuar këto arritje:

- ka arritje të rëndësishme në drejtim të efikasitetit të organizimit të brendshëm dhe funksionimit institucional në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ka arritje të rëndësishme në drejtim të sigurimit të cilësisë;
- ka arritje të rëndësishme në drejtim të optimizimit të ngarkesës së programeve të studimit;
- ka arritje në drejtim të përmirësimit të strukturës dhe të cilësisë së personelit akademik;
- institucioni ka një stabilitet relativ i cili duhet të përmirësohet në drejtim të optimizimit të programeve të studimit dhe kostos së tyre.

Duke iu referuar objektivave sipas fushave të planit strategjik të zhvillimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës shënoi këto arritje gjatë vitit akademik 2020-2021:

1. Në aspektin e zhvillimit institucional

- Bazuar në neni 30, pika 6; neni 38, pika 1/ë; neni 38, pika 2 të Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Statutin e UST-së u kryen ndryshime të njësive bazë, që konsistojnë në

hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e tyre. Ndryshimet u konsideruan të bazuara, të argumentuara, të përshtatshme, që pasqyrojnë më mirë kontekstin aktual dhe mbështesin zhvillimin e mëtejshëm institucional dhe veprimtarinë akademike dhe kërkimore.

- U përmirësuan emërtimet e departamenteve duke i përshtatur më mirë me fushat e studimit që mbulojnë, me programet e studimit dhe me emërtimet e fakulteteve.
- U plotësua dhe përmirësua dokumentacioni rregullator dhe i politikave me Rregulloren e Rektoratit, Politikën e Sigurimit të Cilësisë, Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Rregulloren e Bibliotekës, Rregulloren e Transferimeve etj .
- U shënuan arritje në ndryshimin e imazhit të institucionit nëpërmjet rritjes së visibilitetit në media, kontakteve të drejtpërdrejta me shkollat e mesme, zgjerimit të partneritetit me institucione dhe organizata të ndryshme, zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- U vunë në rrugën e zgjidhjes disa probleme institucionale me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit e QSHA, të mbartura nga vitet e mëparshme.

2. Në aspektin e përsosmërisë akademike

- U pasurua oferta akademike me programin e studimeve të ciklit të tretë
- U përmirësuan kurrikulat e programeve të studimit sipas percaktimeve në Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.
- U zbatua qasja “studenti në qendër” të mësimdhënies dhe të gjithë veprimtarisë së institucionit.
- U përmirësua cilësia e personelit akademik me rekrutimin e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm me tituj e grada, me përvoja akademike dhe administrative, me ekspertizë në fushë dhe personalitete të spikatura.
- U zhvilluan leksione të hapura dhe trajnime me personelin akademik dhe studentët.
- U pasurua teknologjia mësimore në shërbim të studentëve dhe pedagogëve.

3. Në aspektin e kërkimit dhe zhvillimit

- Universiteti i Sporteve të Tiranës organizoi një konferencë shkencore ndërkombëtare të përbashkët me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- Universiteti i Sporteve të Tiranës organizoi disa sesione shkencore e simpoziume zhvillimi.
- U publikuan revista me punimet shkencore.
- Pedagogët kanë marrë pjesë individualisht në konferenca shkencore të organizuara brenda dhe jashtë vendit.
- U fitua një projekt për rritjen e kapaciteteve të kërkimit shkencor.

4. Në aspektin e zhvillimit të partneriteteve

- U nënshkruan 17 (shtatëmbëdhjetë) marrëveshje të reja bashkëpunimi.
- U rinovuan 3 (tre) marrëveshje bashkëpunimi.
- Janë në proces nënshkrimi dhe 11 (njëmbëdhjetë) marrëveshje bashkëpunimi.

5. Në aspektin e ndërkombëtarizimit

- U riaktivizuan duke u vënë në eficiencë projektet ndërkombëtare të bashkëpunimit Erasmus+ për mobilitete individuale të personelit akademik, administrativ dhe studentëve.

- U rinovua marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin e Edukimit Fizik të Budapestit-Hungari dhe me Universitetin e Romës Foro Italico, Itali.
- U negociua për projekte të reja bashkëpunimi me universitete në Greqi, Itali, Hungari, Rumani, Kosovë.

6. *Në aspektin e sigurimit të cilësisë*

- U miratua politika e sigurimit të cilësisë e UST-së
- U kryen vlerësimet periodike për pedagogët dhe personelin akademik.
- U kryen vlerësimet periodike nga studentët për mësimdhënien dhe veprimtarinë e departamenteve.
- U riakreditua nga ASCAL institucioni me rezultate vlerësimi të shkëlqyera.

Sfida

Gjatë vitit akademik 2020-2021, Universiteti i Sporteve të Tiranës ndeshi disa sfida:

- Sfida për rekrutimin e studentëve për shkak të situates pandemike dhe faktorëve të tjerë të tregut.
- Sfida e ofertës së programeve akademike.
- Sfida e garantimit kualitativ të personelit akademik.
- Sfida e zhvillimit të kërkimit shkencor.
- Sfida e modernizimit të teknologjisë në funksion të procesit akademik dhe atij të kërkimit.
- Plotësimi me sukses i objektivave akademik të programeve mësimore në kushtet e pandemisë.

Synime për vitin akademik 2021-2022

1. Realizimi i objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik të Zhvillimit.
2. Pasurimi i portofolit të dokumenteve të politikave dhe dokumenteve rregullatore për të mbështetur një organizim dhe qeverisje më efektive.
3. Pasurimi i ofertës akademike me programe të reja studimi dhe kurse të formimit të vazhduar.
4. Përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies.
5. Përgatitja e paketës së projekteve kërkimore që do të ndërmerren në emër të UST-së
6. Zgjerimi i partneriteteve për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve duke krijuar forumet dhe mekanizmat përkatës.

III. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR UST LIDHUR ME STRUKTURËN E PËRGJITHSHME ORGANIZATIVE, NJËSITË PËRBËRËSE DHE AUTORITETET DREJTUESE PËRKATËSE

Tabela 1

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE AKADEMIKE PËR PERIUDHËN DHJETOR 2020 - DHJETOR 2021
ORGANIZIMI AKADEMIK
Organe drejtuese
Senati Akademik
Rektorati
Dekanati
Këshilli i Etikës
Komisionet e Përhershme
<i>a) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik;</i>
<i>b) Komisioni i Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore;</i>
<i>c) Komisioni i Mbarëvatjes dhe Vemprimit të Marrëdhënieve me Studentët;</i>
<i>ç) Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave;</i>
Autoritetet akademike drejtuese
Rektori
Drejtuesi i njësisë kryesore
Drejtuesi i njësisë bazë
ORGANIZIMI ADMINISTRATIV
Bordi i Administrimit
Administratori i Institucionit
STRUKTURA INSTITUCIONALE
Njësitë kryesore dhe bazë
Fakulteti Shkencave të Lëvizjes
<i>Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit</i>
<i>Departamenti i Sporteve Kolektive</i>
<i>Departamenti i Sporteve Individuale</i>
Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
<i>Departamenti i Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit</i>
<i>Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit</i>
<i>Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit</i>
Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit
<i>Departamenti i Shkencave Biomjeksore dhe Humane</i>
<i>Departamenti i Kineziologjisë</i>
<i>Departamenti i Rehabilitimit</i>
Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit
<i>Departamenti i Performancës Sportive</i>

<i>Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit</i>
<i>Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë</i>
Njësi të tjera
<i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i>
<i>Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Arkiv-Protokollit</i>
<i>Drejtoria Juridike dhe e Zhvillimit të Kurrikulave</i>
<i>Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikum dhe Studentët</i>
<i>Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore</i>
<i>Dega e Bibliotekës Shkencore e Digjitale</i>
<i>Drejtoria e Financës dhe Buxhetit</i>
<i>Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse</i>

IV. INFORMACION MBI REALIZIMIN E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES, TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE VEPRIMTARIVE KRIJUESE DHE INOVACIONIT

Universiteti i Sporteve të Tiranës e ka zhvilluar veprimtarinë e vet bazuar në Planin Strategjik të Zhvillimit 2020-2026. Ky dokument, i miratuar në Dhjetor 2020, përmban piketat e zhvillimit të institucionit për një periudhë 6-vjeçare. Janë parashikuar proceset e ndryshimeve dhe mënyrat e transformimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës në një qëndër elitare të zhvillimit dhe kërkimit në shkencat sportive dhe të shëndetit, rekreacionit, të edukimit fizik e shëndetësor, të menaxhimit të sporteve dhe turizmit aktiv e rekreacional. Zhvillimi strategjik përfshin tre procese: ndryshimin e kulturës, ndryshimin e strukturës, ndryshimin e procesit në institucion.

Ky plan strategjik mbështet zgjedhjet që ne bëjmë për zhvillimin tonë institucional. Këto zgjedhje mbështeten në trashëgiminë dhe vlerat që institucioni ka krijuar, duke iu përgjigjur një konteksti në ndryshim të shpejtë. Ky plan vendos një axhendë të nivelit të lartë për UST-në, e cila varet në masë të madhe edhe nga mjedisi i jashtëm. Ne kemi përgatitur planin strategjik të zhvillimit për të përmbushur aspiratat tona.

Plani Strategjik i Zhvillimit 2020-2026 ka përcaktuar vizionin, misionin dhe fushat me përparësi strategjike. Dokumenti i planit strategjik të zhvillimit përmban prioritetet strategjike, objektivat për secilin prioritet, veprimet dhe rezultatet e pritshme për secilin objektivi.

Misioni i UST-së është: t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimit, kërkimit shkencor, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve; garantimit të suksesit të studentëve në një mjedis global; ofrimit të shërbimeve akademike dhe zhvillimit të një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës.

Gjatë vitit akademik 2020-2021, Universiteti i Sporteve të Tiranës nëpërmjet organeve kolegjiale dhe strukturave përgjegjëse ka punuar frontalisht në të gjitha fushat prioritare, për objektiva të caktuara të tyre:

Prioriteti strategjik : Zhvillimi institucional

- Riorganizimi i departamenteve ekzistuese, hapja e departamenteve të reja
- Përgatitja e dokumenteve të politikave
- Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator
- Trajtimi i studentëve si partnerë aktivë në arsimimin e tyre
- Përgatitja e paketës me instrumentet e fidbekut të studentëve për përvojën arsimore në UST.

Prioriteti strategjik : Përbushja e standardeve të përsosmërisë akademike

- Përmirësimi i kurrikulës
- Hapja e programeve të reja të studimit
- Krijimi i Komisioneve të Përhershme
- Përsosmëri në mësimdhënie dhe të nxënë

Prioriteti strategjik : Kërkimi

- Lidhja e kërkimit me mësimdhënien
- Përgatitja e portofolit të kërkimit të institucionit

Prioriteti strategjik : Zhvillimi i partneritetit

- Zgjerimi i partneriteteve për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve

Prioriteti strategjik : Ndërkombëtarizimi

- Të zhvillohet lëvizshmëria e studentëve dhe shkëmbimeve të stafit
- Përshtatja e kurrikulave të programeve ekzistuese me ato të partnerëve tanë ndërkombëtarë

Prioriteti strategjik : Sigurimi i cilësisë

- Të gjitha standardet e cilësisë duhet të përmbushen përmes proceseve të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit
- Të përmirësohet funksionimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë
- Publikimi i politikës dhe i rregullores për sigurimin e brendshëm të cilësisë
- Realizimi i vlerësimit të brendshëm
- Realizimi i riakreditimit institucional
- Vendorsja e dialogut me vlerësuesit e jashtëm

Misioni i Universitetit të Sporteve të Tiranës është konceptuar në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të paraqitur në nenin 1 të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me karakteristikat specifike që mbart dhe vlerën e shtuar që synon të sjellë Universiteti i Sporteve të Tiranës në fushën e arsimit të lartë si dhe me misionin e arsimit të lartë në shekullin e 21-të.

Në përmbushje të këtij misioni, Universiteti i Sporteve të Tiranës kreu këto veprimtari gjatë vitit akademik 2020-2021:

- a. Ofroi arsimim për të gjithë studentët që zgjodhën programet e studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në UST.

- b. Punoj për të pasuruar ofertën akademike me programe të reja studimi të ciklit të dytë dhe të tretë si dhe për të përmirësuar kurrikulat e programeve ekzistuese të studimit.
- c. Mësimdhënia u integrua më mirë me kërkimin duke përdorur qasjet:
- *mësimdhënia e udhëhequr nga kërkimi;*
 - *mësimdhënia e orientuar drejt kërkimit;*
 - *mësimdhënia e bazuar në mentorimin kërkimor;*
 - *mësimdhënia e bazuar në kërkim;*
 - *kërkimi është i ndikuar nga mësimdhënia.*
- d. Universiteti i Sporteve të Tiranës organizoi vetëm një konferencë shkencore ndërkombëtare të përbashkët me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, për shkak të pandemisë COVID-19 nuk u bë e mundur që të kishte edhe më shumë. Njësitë kryesore dhe bazë të UST-së organizuan disa sesione e simpoziume shkencore zhvillimi. Pedagogët realizuan kërkime dhe botime individuale.
- e. U zbatua qasja “studenti në qendër” të veprimtarisë mësimore dhe të veprimtarive të tjera të institucionit që ndikoi në aktivizimin më të madh të studentëve dhe në nxitjen e zhvillimit individual të tyre gjë që i shërben transformimit të jetëve që është edhe pjesë e misionit të UST-së.
- f. Lidhur me ofrimin e shërbimeve akademike, anëtarët e komunitetit të UST-së kanë kryer veprimtari që lidhen me shërbime ndaj institucionit, si pjesëmarrja në organet drejtuese, kryerja e punës mbështetëse administrative, shërbimi në grupe pune për çështje me të cilat është përbashkët komuniteti i institucionit, veprimtari të drejtimit të fakulteteve, kontributi për mbështetjen e veprimtarisë së studentëve; angazhimi si ekspertë në çështje jashtë institucionit, shërbim për agjencitë qeveritare; pjesëmarrja në përpyekjet bashkëpunuese me shkollat, agjencitë; shërbime për komunitetin, si procese informuese në shkollat e mesme të vendit, mundësi që studentët të provojnë përvojat profesionale në kampus, në organizata të llojeve të ndryshme jashtë institucionit.
- Nisur nga rezultatet e arritura dhe objektivat e përcaktuara, Universiteti i Sporteve të Tiranës gjatë vitit të ardhshëm akademik do të punojë për të përmbushur objektivat e Planit Strategjik të Zhvillimit 2020-2026, sipas planit konkret të veprimit.

V. INFORMACION PËR BASHKËPUNIME NDËRINSTITUCIONALE DHE PROJEKTE KU MERR PJESË UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Bashkëpunimi dhe ndërtimi i partneriteteve me organizata jashtë institucionit është jetësor për arritjen e vizionit dhe përmbushjen e misionit të UST-së.

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka bashkëpunime me institucione dhe organizata të llojeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si me institucione të arsimit të lartë, me institucione shtetërore, me institucione të pavarura, institucione të arsimit të lartë, me institucione të sportit e të shëndetit, me organizata profesionale, me organizata të biznesit në fushën e sportit, shëndetit dhe të turizmit e shërbimit. Këto bashkëpunime dhe partneritete mundësojnë përvoja praktike për studentët, shkëmbim të personelit dhe të studentëve; ofrojnë mundësi punësimi për të diplomuarit; mundësojnë veprimtari të përbashkëta kërkimore, trajnime, dhënie konsulence dhe ekspertize. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve Universiteti i Sporteve të Tiranës përcjell përvojën e vet më të mirë tek partnerët dhe jep kontribut në zhvillimin e shoqërisë.

Në kuadrin e Planit Strategjik të Zhvillimit 2020-2026, Universiteti i Sporteve të Tiranës ka përcaktuar disa objektiva në fushën e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar që synojnë shtimin dhe zgjerimin e partneriteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të mbështetur mësimdhënien, të nxënit, kërkimin, punësimin e studentëve dhe shkëmbimin e përvojave.

Në përmbushje të misionit të tij, UST ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si me institucione të arsimit të lartë, me kompani biznesi, institucione të sportit, shkolla, spitale, laboratorë mjekësorë. (shih të dhënat në tabelat më poshtë)

Bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit

Bashkëpunimi i UST-së me IAL brenda dhe jashtë vendit mundëson shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve, përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe angazhimin në projekte të përbashkëta.

Bashkëpunimi midis palëve është përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Bashkëpunim akademik në fushat e mësimdhënies dhe të kërkimit, si dhe në fusha të tjera me interes të ndërsjelltë.
- Shkëmbime dhe pjesëmarrje në eksperiencë mësimore të stafit akademik dhe në fushën e kërkimit shkencor.
- Pjesëmarrje të studentëve në programin Erasmus+ për të përfituar nga mundësitë e ofruara nga angazhimi i Shqipërisë në programin Erasmus+ për lëvizshmërinë e studentëve.
- Pjesëmarrje të pedagogëve në programin Erasmus+ për të përfituar nga mundësitë e ofruara nga angazhimi i Shqipërisë në programin Erasmus+ për lëvizshmërinë e pedagogëve.
- Pjesëmarrja në projekte të përbashkëta, konferenca dhe aktivitete të tjera akademike me rëndësi për të dy palët.
- Shkëmbime të informacionit akademik, mësimor dhe kërkimor.

Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera

Për realizimin e misionit të tij, Universiteti i Sporteve të Tiranës ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh ku studentët kryejnë praktikën, shkëmbejnë eksperiencat dhe fitojnë aftësi profesionale. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit është aftësimi profesional i studentëve, kryerja e praktikave profesionale, mundësia për trajnime dhe internshipe, mbështetja për kryerjen e temave të diplomave si dhe mundësia që u jepet studentëve më të mirë për t'u punësuar në këto institucione.

Gjatë vitit 2020-2021 u lidhën marrëveshje të reja bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, si: Universiteti "Aleksandër Moisiu"- Durrës; Universiteti "Fan S. Noli" - Korçë; Universiteti "Luigj Gurakuqi" - Shkodër, Universiteti Katolik "Zonja e Këshillit të Mirë", Kolegji "Heimerer"; institucione qëndrore të vendit, si: Akademia e Shkencave të Shqipërisë; Federata Shqiptare e Futbollit; Federata Shqiptare e Gjymnastikës, Spitali Universitar i Traumës, Universiteti Shtetëror i Michiganit (në bashkëpunim me MAS) si me institucione të tjera, si: WBS Recruiting, Albania Adventure, Klinika Tranquility, Klinika Fizio+, Fondacioni i Rehabilitimit Alliance, Klinika Orthomed Sport, Klinika Medal Physiotherapy.

U rinovuan marrëveshje bashkëpunimi me Universiteti i Edukimit Fizik-Budapestit, Universiteti i Romës “Foro Italico”, Universiteti Europian i Tiranës.

Janë në proces nënshkrimi këto marrëveshje: Universiteti Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës, Spitali Universitar “Nënë Tereza”, Bashkia Tiranë, Shoqëria “Magi Euregio”, Federata Shqiptare e Mundjes, Federata Shqiptare e Boksit, Federata Shqiptare e Teqball, AADF – Programi Clean Score, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, World Vision dhe Shoqata “Special Olympic.

Synimi për vitin e ardhshëm akademik do të jetë:

- zgjerimi i partneriteteve me institucione vendase dhe të huaja për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve;
- krijimi i një forumi të përhershëm me punëdhënësit.

TABELA 2: INSTITUCIONE PARTNERE TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Institucioni bashkëpunues	Shteti	Fusha e bashkëpunimit
Universiteti i Edukimit Fizik-Budapestit	HUNGARI	- shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve; - përmirësimin e procesit të mësimdhënies; - angazhimin në projekte dhe programe të përbashkëta.
Universiteti i Romës “Foro Italico”	ITALI	- shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve; - përmirësimin e procesit të mësimdhënies; - angazhimin në projekte dhe programe të përbashkëta.
Universiteti Europian i Tiranës	SHQIPËRI	- shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve, - përmirësimin e procesit të mësimdhënies; - angazhimin në projekte dhe programe të përbashkëta.
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	KOSOVË	- shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve; - përmirësimin e procesit të mësimdhënies; - angazhimin në projekte dhe programe të përbashkëta.

Universiteti "Aleksandër Moisiu"- Durrës	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve; - përmirësimin e procesit të mësimdhënies; - angazhimin në projekte dhe programe të përbashkëta.
Universiteti "Fan S. Noli" - Korçë	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve; - përmirësimin e procesit të mësimdhënies; - angazhimin në projekte dhe programe të përbashkëta.
Universiteti "Luigj Gurakuqi" - Shkodër	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve; - përmirësimin e procesit të mësimdhënies; - angazhimin në projekte dhe programe të përbashkëta.
Universiteti Katolik "Zonja e Këshillit të Mirë"	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve; - përmirësimin e procesit të mësimdhënies; - angazhimin në projekte dhe programe të përbashkëta.
Kolegji "Heimerer"	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve; - përmirësimin e procesit të mësimdhënies; - angazhimin në projekte dhe programe të përbashkëta.
Akademia e Shkencave të Shqipërisë	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta kërkimore shkencore; - përfshirjen në komisione të përhershme; - pjesëmarrjen në këshillin e botimeve akademike.
Federata Shqiptare e Futbollit	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - aftësimi profesional i studentëve; - kryerja e praktikave profesionale; - mundësia për trajnime dhe internshipe, mbështetja për kryerjen e temave të diplomave;

		<ul style="list-style-type: none"> - investime në infrastrukturën e universitetit; - mundësi punësimi për studentët; - organizimi i aktiviteteve të përbashkëta.
Federata Shqiptare e Gjimnastikës	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - aftësimi profesional i studentëve; - mundësi punësimi për studentët; - organizimi i aktiviteteve të përbashkëta.
Spitali Universitar i Traumës	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - kryerja e praktikave profesionale; - organizimi i leksioneve të hapura, forumeve dhe konferencave,
Universiteti Shtetëror i Michiganit (në bashkëpunim me MAS)	SHBA	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunim në fushën akademike dhe të kërkimit
WBS Recruiting	GJERMANI	<ul style="list-style-type: none"> - mundësi trajnimit dhe zhvillim karriere në Gjermani; - mundësi punësimi për studentët në Gjermani.
Albania Adventure	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - mundësia për trajnime dhe internshipe; - ndihmë për realizimin e procesit mësimor; - kryerja e praktikave profesionale; - mundësi punësimi për studentët.
Klinika Tranquility	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - realizimi i aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta; - mbështetje në kryerjen e studimeve në fushën e rehabilitimit; - kryerja e praktikave profesionale; - mundësi punësimi për studentët.
Klinika Fizio+	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - realizimi i aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta; - mbështetje në kryerjen e studimeve në fushën e rehabilitimit; - kryerja e praktikave profesionale; - mundësi punësimi për studentët.
Fondacioni i Rehabilitimit Alliance	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - realizimi i aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta; - mbështetje në kryerjen e studimeve në fushën e rehabilitimit; - kryerja e praktikave profesionale; - mundësi punësimi për studentët.
Klinika Orthomed Sport	SHQIPËRI	<ul style="list-style-type: none"> - realizimi i aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta; - mbështetje në kryerjen e studimeve në fushën e rehabilitimit; - kryerja e praktikave profesionale;

		- mundësi punësimi për studentët.
Klinika Medal Physiotherapy.	SHQIPËRI	- realizimi i aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta; - mbështetje në kryerjen e studimeve në fushën e rehabilitimit; - kryerja e praktikave profesionale; - mundësi punësimi për studentët.

Në kuadrin e Programit Evropian ERASMUS+, gjatë vitit akademik 2020-2021, Universiteti i Sporteve të Tiranës ka realizuar mobilitete individuale të personelit akademik dhe administrativ dhe ka pritur mobilitete nga universitetet evropiane..

TABELA 3: BASHKËPUNIME ERASMUS+ 2020-2021

Institucioni bashkëpunues	Shteti	Fusha e bashkëpunimit	Kohëzgjatja e bashkëpunimit	Mobilitete të personelit 2020-2021	Mobilitete të studentëve 2020-2021
UNIVERSITETI I EDUKIMIT FIZIK TË BUDAPESTIT	HUNGARI	SHKËMBIMI I STAFIT DHE STUDENTËT	2020-2023	3	2 (dy) Mobilitet për studentët nuk u realizuan, dhe janë planifikuar për vitin 2021-2022
UNIVERSITETI I ARADIT "AUREL VLAICU"	RUMANI	SHKËMBIMI I STAFIT DHE STUDENTËT	2020-2023	3 (tre) Mobilitet për stafin nuk u realizuan, dhe janë planifikuar për vitin 2021-2022	2 (dy) Mobilitet për studentët nuk u realizuan, dhe janë planifikuar për vitin 2021-2022

TABELA 4

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënë për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	Universiteti i Edukimit Fizik të Budapestit, Hungari dhe UST, Shqipëri
Statusi i projektit	Në proces
Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndërinstitucionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënë në fushën e sportit, edukimit fizik dhe shëndetit , veprimtarise fizike dhe sporteve rekreacionale, menaxhimit te sporteve dhe turizmit te aventures , kerkimit shkencor ne te gjitha keto fusha .
Detyrat e palëve	<p><i>Detyrat e Universiteti i Edukimit Fizik të Budapestit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifike të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuara në kontratë (niveli B2 në Anglisht ose ne nje nga gjuhet e miratuara nga ministria pergjegjese per arsimin e larte ne Shqiperi). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin. • Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënit për studentët. <p><i>Detyrat e Universiteti i Sporteve të Tiranës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt. • Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga Universiteti i Edukimit Fizik të Budapestit për në UST. • Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënit për studentët.
Pritshmëritë e projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënë. • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik.
Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2020-2021	<ul style="list-style-type: none"> • 5 mobilitete nga Universiteti i Sporteve të Tiranës në Universiteti i Edukimit Fizik të Budapestit, nga të cilat 1 mobilitete të personelit akademik dhe 2 mobilitete të personelit administrative dhe 2 mobilitete të studentëve.

TABELA 5

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënë për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	Universiteti i Aradit “Aurel Vlaicu”, Rumani dhe UST, Shqipëri
Statusi i projektit	Në proces
Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndërinstitucionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënë në fushën e sportit, edukimit fizik dhe shëndetit , veprimtarise fizike dhe sporteve rekreacionale, menaxhimit te sporteve dhe turizmit te aventures , kerkimit shkencor ne te gjitha keto fusha .
Detyrat e palëve	<p><u><i>Detyrat e Universiteti i Aradit “Aurel Vlaicu”, Rumani</i></u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifike të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuara në kontratë (niveli B2 në Anglisht ose ne nje nga gjuhet e miratuara nga ministria pergjegjese per arsimin e larte ne Shqiperi). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin. • Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënës për studentët. <p><u><i>Detyrat e Universiteti i Sporteve te Tiranes</i></u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt. • Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga Universiteti i Aradit “Aurel Vlaicu”, Rumani për në UST. • Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënës për studentët.
Pritshmëritë e projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënë • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik
Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2018-2019	<ul style="list-style-type: none"> • 5 mobilitete nga Universiteti i Sporteve te Tiranes në Universiteti i Aradit “Aurel Vlaicu”, Rumani, nga të cilat 2 mobilitete të personelit

	akademik dhe 1 mobilitete të personelit administrative dhe 2 mobilitete të studentëve.
--	--

**TABELA 6: PJËSËMARRJA E UNIVERSITETI TË SPORTEVE TË TIRANËS
NË PROJEKTET NDËRKOMBËTARE**

NR.	FINANCIMI	KOHEZGJATJA E PROJEKTIT	NUMRI I REFERENCËS	EMRI I PROJEKTIT /QËLLIMI
1.	PROGRAMI ERASMUS +	3 vjet Nentor 2017- Dhjetor 2020	586300- EPP-1- 2017-1- ES- EPPKA2- CBHE-SP	<p>TEAVET PROJECT <i>“Developing teacher competences for a comprehensive VET system in Albania”</i></p> <p>Projekti TEAVET - Zhvillimi i aftësive të mësuesit për një sistem gjithëpërfshirës të edukimit dhe aftësimit profesional në shqipëri</p> <p>Ky projekt konsiston në zhvillimin e ekspertizës akademike përmes ngritjes së qendrave të specializuara në universitetet shqiptare dhe ofrimin të programeve të kualifikimit standard të një kualiteti të lartë në fushën e zhvillimit të kompetencave profesionale të mësuesve në Shqipëri gjatë gjithë jetës.</p> <p><u>Rezultati: Ngritja e Qendrës së Trainimeve dhe Formimit të Vazhduar në UST dhe ofrimin e 16 moduleve për të gjithë mësuesit.</u></p>
2.	PROGRAMI ERASMUS+	3 vjet Janar 2021 – Janar 2024	617886- EPP-1- 2020-1- FI- EPPKA2- CBHE-SP	<p>EntrAL PROJECT <i>“Entrepreneurial skills for a modern education in Albania”</i></p> <p>Projekti EntraL –“Aftësitë sipërmarrëse - për një arsimim modern në Shqipëri”</p> <p>Ky projekt synon rritjen e ndërgjegjësimit sipërmarrës në Institucionet Arsimore Shqiptare (universitete dhe shkolla) për të mbështetur aftësitë e të diplomuarve që përputhen me kërkesat e tregut së punës dhe shoqërisë moderne.</p> <p>Qëllimi kryesor është të sjelli një mendim sipërmarrës në universitete dhe nivelet e shkollës duke inkurajuar metodat e mësimdhënies sipërmarrëse dhe të kultivojnë sjellje sipërmarrëse nga studentët dhe për të mbështetur krijimin e fillimi i studentëve.</p> <p>Mësuesit do të mbështeten nga struktura universitare dhe mekanizmat (LLL, aktivitetet</p>

				<p>për stafin); të cilit më pas e përcjellin tek nxënësit aftësitë në lidhje me qëndrim sipërmarrës, duke mbështetur punësimin e tyre pas diplomimit.</p> <p>Janë realizuar dy takime : një në Shkoder dhe një në Finlandë.</p>
3.	KOMISIONI EUROPIAN	24 muaj Janar 2021 – Dhjetor 2022	EAC- 2020-0718	<p>BeACTIVE “EUYouth – European Week of Sport beyond Borders in the Western Balkans”.</p> <p>Përfituesi kryesor i këtij projekti është <i>Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë</i>.</p> <p>Në planin e veprimtarive të parashikuara për realizimin e këtij projekti është edhe studimi që do të kryhet nga Instituti i Kerkimit Shkencor të Sport (UST) “Promoting health-enhancing physical activity” / “Promovimi i kontributit të veprimtarisë fizike tek shëndeti” - qëllimi i të cilit është evidentimi i treguesve fizik e funksional në popullatë, përfshirë grupet 6 - 10, 11 - 14, 15-18, 19 - 25, 25 - 45, 46 vjeç në rank vendi.</p> <p>Gjetjet e këtij studimi do të shoqërohen me rekomandime për përmirësimin e kapaciteteve fiziko-funksional, shëndetësor e lëvizor, të cilat do të përcillen si informacion/database të dhenash ne platformen evropiane EUROFIT, në respektim të Rekomandimit të Komisionit Evropian date 26 nëntor 2013 “On promoting health-enhancing physical activity across sectors” (Promovimi nderktoial i veprimtarise fizike në shërbim të rritjes së shendetit.)</p> <p>Janë realizuar ekspedita matjesh në qytetet: Peshkopi, Kukës, Korçë, Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Tiranë.</p>
4	INSTITUTI DANEZ I STUDIMEVE E TË SPORTIT	2020-2021	2019-20-DK- 27782515	<p>PLAY THE GAME PROJECT “National Sports Governance Observer (NSGO 2). Indicators and instructions for assessing good governance in national sports federations”</p> <p>Projekti Luaj Lojën – “Observatori Kombëtar i Qeverisjes së Sportit (NSGO 2). Treguesit dhe udhëzimet për vlerësimin e qeverisjes së mirë në federatat kombëtare të sporteve.”</p>

				<p>Qëllimi kryesor i këtij projektit është të ndihmojë dhe frymëzojë organizatat kombëtare sportive për të përmirësuar cilësinë e praktikave të tyre të qeverisjes.</p> <p>Më konkretisht, projekti përcakton:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të aftësojë drejtuesit sportivë dhe palët e interesuara të jashtme të masin, diskutojnë dhe ndryshojnë standardet e qeverisjes dhe praktikave të organizatave sportive duke përshtatur dhe duke aplikuar treguesit e Observatorit Kombëtar të Qeverisjes së Sportit në federatat kombëtare të sporteve; <p>krijimi i rrjeteve të qëndrueshme ndërmjet akademikëve, praktikuesve dhe çelësve të tjerë aktorët me interes të përbashkët për qeverisje të mirë në sport në një nivel kombëtar si dhe ndërkombëtar përmes seminareve kombëtare të trainimit dhe konferencës.</p>
--	--	--	--	---

VI. INFORMACION PËR KËRKIMIN SHKENCOR

Politika e kërkimit shkencor

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka punuar për ta realizuar kërkimin shkencor në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe përcaktimet në Statut.

Kërkimi shkencor është përcaktuar si prioritet strategjik në Planin Strategjik të Zhvillimit 2020-2026. Politika e kërkimit shkencor ka në bazë këto parime kryesore.

1. Kalimi nga qasja individuale në qasjen bashkëpunuese në kërkim. Kjo qasje është pranuar për disa arsye:

- a) Kërkimi është më efektiv kur studiuesit me ekspertizë nga fusha të ndryshme bashkëpunojnë në një projekt kërkimi të përbashkët.
- b) Sa më shumë studiues të bashkëpunojnë, aq më të mëdha janë shanset për sukses dhe zgjidhjen e problemeve.
- c) Në rastin e UST-se si një institucion publik jo-fitimprures, burimet janë të kufizuara, ndaj bashkëpunimi bëhet veçanërisht i vlefshëm si një mjet për të fituar njohuri dhe përvojë.
- d) Bashkëpunimi me ekipe të tjera hulumtuese e bën kërkimin një proces më të lehtë, duke shkëmbyer informacione mbi situata të ngjashme me të tjerët dhe duke përdorur teknikat dhe

përvojat e tyre më të suksesshme. Kjo qasje i jep përparësi veprimtarisë kërkimore në nivelin e njësisë bazë dhe të universitetit. Kjo qasje nuk e përjashton veprimtarinë individuale, pasi në bazë të legjislacionit në fuqi, kërkimi është një komponent i ngarkesës së punës të personelit akademik dhe është një produkt që përdoret për qëllimin individual të lidhur me promovimin në karrierën akademike.

2. Kryerja e kërkimeve që të kenë ndikim në shoqëri. Duke vlerësuar se kërkimi shkencor ka ndikime të konsiderueshme në shoqëri, Universiteti i Sporteve të Tiranës ka përcaktuar si një parim kryesor kryerjen e kërkimeve për çështje që e interesojnë shoqërinë në fushën e shkencave të sportit e shëndetit, në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit të aventurës dhe rekreacional, në fushën e edukimit fizik dhe shëndetit si dhe të mireqenies së popullatës në përgjithësi.

3. Ndërthurja e kërkimit me mësimdhënien. Universiteti i Sporteve të Tiranës synon që pedagogët të jenë kërkues aktivë që ata të transferojnë në mënyrë të natyrshme rezultatet e kërkimit në mësim; që mësimi të aftësojë studentët të ushtrohen për detyra kërkimore të vogla; që mësimi të ilustrohet me arritjet shkencore të fushës.

4. Zhvillimi i aftësive kërkimore të studentëve. Sipas këtij parimi, Universiteti i Sporteve të Tiranës synon që specialistët e ardhshëm të kenë kapacitetin të integrojnë kërkimin në praktikën e tyre profesionale: për shkak të natyrës praktike të profesioneve për të cilat ata përgatiten; për shkak se ata duhet të zbulojnë dhe analizojnë problemet që mund të ndeshin në punën e tyre të ardhshme; për shkak se ata duhet të jenë të aftë të studiojnë dhe të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale në vijimësi.

Për të realizuar këtë parim, gjatë vitit 2020-2021 u përmirësuan programet e studimit duke përfshirë në kurrikulat e të gjitha programeve të ciklit të dytë lëndë për kërkimin shkencor dhe duke forcuar elementin kërkimor në të gjitha lëndët mësimore të programeve të tjera.

Një tregues tjetër është përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimore e cila është realizuar si nëpërmjet përfshirjes së tyre në grupet e kërkimit dhe mbështetjen e projekteve kërkimore që institucioni ka në vazhdimësi, ashtu edhe në mbrojtjen e mikrotezave të studentëve të ciklit të dytë të studimeve.

Nga analizat e zhvilluara, është konstatuar se studentët janë më tepër konsumatorë sesa prodhues të kërkimit. Për të ndryshuar këtë status, për t'i aftësuar studentët të jenë të aftë që të përdorin, por edhe të prodhojnë kërkim në mënyrë që të zhvillohen profesionalisht, gjatë vitit 2020-2021 veprimtaritë mësimore janë organizuar në mënyrë të tillë që studentët të praktikojnë argumentimin, studimin e rasteve, marrjen e vendimeve dhe paraqitjen e arsyetimeve kur hulumtojnë për zgjidhjen e problemeve, kryerjen e detyrave me elemente të kërkimit.

Personeli akademik, individualisht u përfshi në veprimtari kërkimore dhe zhvillimi përmes pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit, botimeve të artikujve shkencorë, udhëheqjes së mikro-tezave për mbrojtjen e diplomave të studentëve të ciklit të dytë të studimeve si dhe pjesëmarrjes në projekte kërkimi.

Informacion për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Për të realizuar realisht lidhjen e mësimdhënies me kërkimin, gjatë vitit akademik 2020-2021 u përdorën qasjet:

- *mësimdhënia e udhëhequr nga kërkimi*, e cila u realizua nëpërmjet integritit në mësimdhënie të rezultateve të kërkimeve aktuale sipas disiplinave mësimore;
- *mësimdhënia e orientuar drejt kërkimit*, e cila u realizua nëpërmjet të kuptuarit dhe zbatimit të metodologjive, aftësive dhe teknikave të kërkimit në disiplina mësimore;
- *mësimdhënia e bazuar në mentorimin kërkimor*, e cila u realizua nëpërmjet mentorimit të pedagogëve për shkrimin e punimeve shkencore të studentëve, për punimet e diplomës; për vlerësimin e punimeve shkencore vecanerisht me studentet e ciklit të dytë të studimeve;
- *mësimdhënia e bazuar në kërkim*, e cila u realizua nëpërmjet detyrave kërkimore të shkallës së vogël në lëndë të veçanta; si ese, studim rasti, analiza klinike;
- *kërkimi është i ndikuar nga mësimdhënia*, e cila u realizua nëpërmjet përfshirjes së studentëve në mbledhjen e të dhënave, të analizës së të dhënave dhe të kryesjes së rolit të vlerësuesit për punimet e njeri tjetrit sipas grupeve.

Produktet në fushën e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit

- 1 Konferencë Shkencore ndërkombëtare.
- 1 Simpoziume
- 3 sesione shkencore zhvillimi
- 62 kumtime nga personeli akademik në konferenca brenda dhe jashtë vendit
 - 29 kumtime në Konferencën Ndërkombëtare
 - 13 kumtime në Simpoziume
 - 19 referime në sesione zhvillimi

TABELA 7: KONFERENCA SHKENCORE DHE TË ZHVILLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Titulli Konferencës	Organizatorët	Data e Zhvillimit	Vendi i Zhvillimit	Botimi
3 rd International Scientific Conference for Physical Education, Sport and Health 22 – 23 December 2021, Pristina	IKSHS dhe Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit, Universiteti i Prishtinës	22 – 23 Dhjetor 2021	Prishtinë, Kosovë	Books of Proceedings and Books of Abstracts

TABELA 8: VEPRIMTARI ZHVILLIMI

Leksione të hapura	Folës	Organizator	Data e zhvillimit	Pjesëmarrës
<i>"The Relevance of Decision Making in Basketball through Some Examples"</i>	Dr. Tamás STERBENZ Rektor8Universiteti i Edukimit Fizik Budapest – Hungari	Rektorati Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët	2 Nentor 2021	Stafi akademik dhe studentët
<i>"Internationalization and Strategic Planning"</i>	Dr. Judit KADAR Drejtoresha e Marrëdhënieve me Jashtë Universiteti i Edukimit Fizik Budapest – Hungari	Rektorati Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët	2 Nentor 2021	Stafi akademik dhe studentët

TABELA 9: SIMPOZIUME

Simpozim	Folës	Organizator	Data e zhvillimit	Pjesëmarrës
Tema e simpoziumit: <i>"Roli i edukimit fizik dhe sportive gjatë periudhës së Pandemisë COVID-19"</i>	Fjala e hapjes 1. Dr. Keida Ushtelenca 2. Prof.Dr. Agron Kasa 3. Prof.Dr. Dhimitraq Prifti	DSHSE	30.06.2021	DSHSE/FSHL DMS/FSHL STUDENTË/FSHL
Tema: <i>"Përvetësimi nga studentët, në kushtet e pandemisë i njohurive Socio-Filozofike të"</i>	Prof.Dr. Fatos Gjata		30.06.2021	DSHSE/FSHL

<i>Edukimit Fizik dhe Sportit</i>				
Tema: <i>"Ndikimi i pandemisë Covid-19 në mësimdhënien e Edukimit Fizik"</i>	Dr. Marsela Shehu		30.06.2021	DSHSE/FSHL
Tema: <i>"Mësimi ONLINE dhe efektshmëria e tij"</i>	Dr. Najada Quka Dr. Rigerta Selenica		30.06.2021	DSHSE/FSHL
Tema: <i>"Informimi dhe pranimi i Rregullores Anti-COVID nga studentët e Universitetit të Sporteve të Tiranës"</i>	Prof.Asc.Dr. Lindita Agolli		30.06.2021	DMS/FSHL
Tema: <i>"Përshtypjet e studentëve të UST mbi disa aspekte të mëimit ONLINE gjatë periudhës së Pandemisë"</i>	Dr. Mirjeta Cenaj		30.06.2021	DSHSE/FSHL
Tema: <i>"Ndikimi i aktivitetit fizik në cilësinë e jetës tek të rriturit"</i>	Dr. Blerina Aliaj		30.06.2021	DSHSE/FSHL
Tema: <i>"Testimet para mini fazës përgatitore të Janarit në KS "Vora"</i>	Ervin Baku (ish-student) Dr. Keida Ushtelena		30.06.2021	ALUMNI DSHSE/FSHL
Tema: <i>"Karakteristikat e</i>	Prof.Asc.Dr. Juel Jarani Msc. Blerina Mema		30.06.2021	DSHSE/FSHL

<i>gjatësisë dhe peshës trupore tek fëmijët</i>				
Tema: <i>"Analizë krahasuese e kurrikulës së vjetër me kurrikulën e re"</i>	Dr. Majlinda Hala		30.06.2021	UA
Tema: <i>"Ndikimi i ushtrimeve të ndryshme të forcës tek aftësia e kërcyeshmërisë të sportistit"</i>	Dr. Rigerta Selenica Dr. Najada Quka		30.06.2021	DSHSE/FSHL
Tema: <i>"Ushtrimi dhe aktiviteti fizik tek fëmijët"</i>	Elona Allmuça (studente) Dr. Rigerta Selenica		30.06.2021	MASTER PROFESIONAL DSHSE/FSHL
Tema: <i>"Faktorët që ndikojnë në performancën sportive"</i>	Kristina Hasa (studente) Dr. Rigerta Selenica		30.06.2021	MASTER PROFESIONAL DSHSE/FSHL

TABELA 10: TRAJNIME

Trajnime	Folës/Trajnues	Organizator	Data e zhvillimit	Pjesëmarrës
<i>"Metodologjitë e mësimdhënies"</i>	Prof.As.Dr. Juel Jarani	FSHL	20 – 22.05.2021	14 mesues
<i>"Mësimdhënia dhe të nxënit me bazë projektin"</i>	Dr. Keida Ushtelenca	FSHL	10 – 12.06.2021	15 mesues

<i>"Vlerësimi i rezultateve të të nxënit"</i>	Msc. Blerina Mema	FSHL	17 – 19.06.2021	17 mesues
<i>"Turizmi i Aventurës: Udhërrëfyesit e Specialitetit të veçantë:Moduli 2 "</i>	Prof. Dr. Agron KASA	FVFR (webinar)	31.10.2020 -08.11.2020	12 kursantë të modulit "Rafting" 15 Pedagogë UST
<i>"Turizmi i Aventurës: Udhërrëfyesit e Specialitetit të veçantë:Moduli 2 "</i>	Prof. Asc. Dr. Ferdinand MARA	FVFR (webinar)	31.10.2020 - 08.11.2020	12 kursantë të modulit "Rafting" 15 Pedagogë UST
<i>"Turizmi i Aventurës:Specialiteti Rafting: Orientim"</i>	Msc. Roland Palushi	FVFR Lokacioni: (Përmet)	09.11.2020 - 15.11.2020	12 kursantë të modulit "Rafting" 12 Pedagogë UST
<i>Praktikë Profesionale Rafting</i>	Lucio Luoni Amadeus Schifferte	FVFR & Federata Botërore e Rafting Lokacioni:(Përmet)	09.11.2020 - 15.11.2020	12 kursantë të modulit "Rafting" 12 Pedagogë UST

Konferenca Ndërkombëtare "3rd International Scientific Conference for Physical Education, Sport and Health 22 – 23 December 2021, Pristina-Kosova".

Kjo konferencë u organizuar nga Universiteti i Sporteve te Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës më 21 – 23 dhjetor 2021. Njësia Kryesore përgjegjëse për organizimin ishte Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit. Konferenca u zhvillua në disa sesione: sesioni plenar me lektor të ftuar, Sesioni i Edukimit Fizik, Sesioni Mjeksisë Sportive, Sesioni i Sportit, Sesioni Sporti dhe Aspektet Psiko-sociale, Sesioni i Manaxhimit në Sport, Rekreacion e Turizëm.

Në këtë konferencë u regjistruan rreth 100 pjesëmarrës dhe u paraqitën prezantime. Pedagogët e UST-së mbajtën 18 kumtime, ndërsa kontribuan me bashkëautorësi 35 pedagogë. 7 anëtar të stafit

akademik të UST-së ishin në Komitetin Shkencor të Konferencës, ndërsa 4 të tjerë në Komitetin Organizativ. Pjesëmarrësit ishin nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Turqia, Austria dhe Mali i Zi. Punimet shkencore të paraqitura u botuan në Librin e Abstrakteve (150 kopje) dhe Proceedings të Konferencës. Konferenca shënoi një ngjarje të veçantë jo vetëm për dimensionin shkencor që karakterizon një konferencë ndërkombëtare, por dhe për të shkëmbyer mendime dhe këndvështrime të reja me personalitete të njohura në fushën e shkencave sportive dhe shendetit, rekreacionit, turizmit aktiv dhe edukimit në përgjithësi dhe atij fizik në veçanti.

Revista Shkencore e UST-së

Mbas një ristrukturimi të procedurave të vlerësimit dhe botimit nga Komisioni i Senatit dhe Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë pranë IKSH-së, njësi bazë përgjegjëse për botimin e revistës, është dërguar për botim numri i radhës së Revistës Shkencore të UST-së “JPAS” – Journal of Physical Activity and Sport”. 16 punime shkencore do të përbajë ky vëllim ku u përfshinë artikuj shkencorë në shkencat sportive, edukimit fizik e shendetsor, rekreacionit, turizmit aktiv dhe shkencave të rehabilitimit dhe shendetit.

Veprimtari zhvillimi:

Simpoziumi me Temë: “Roli i edukimit fizik dhe sporteve gjatë periudhës së Pandemisë COVID-19”.

Shënim: Simpoziumi u zhvillua pranë ambjenteve të UST-së, në sallën A 1.1, datë 30 Qershor 2021.

TABELA 11

Sesione shkencore të organizuara nga Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit

Sesion Shkencor: Aktivitetin fizik në kohën dhe pas COVID-19	Folës	Organizator	Data e zhvillimit	Pjesëmarrës
COVID-19: Vetitë biologjike e gjenetike të SARS-CoV-2, mekanizmi i infektimit dhe mbrojtjes imunitare	Prof. Dr. Dhurata Bozo	IKSHS/DAFSH	22.06.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
Efektet dhe patologjitë e shkaktuara nga	MSc. Suela Xhufi	IKSHS/DAFSH	22.06.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST

SARS-CoV-2 në organizmin e njeriut“				
Rëndësia e Aktivitetit Fizik në kohën dhe pas – COVID-19”	MSc. Denis Nuriu	IKSHS/DAFSH	22.06.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
Rekomandime për zhvillimin e aktivitetit fizik në kohën dhe pas-COVID	MSc. Enkeleda Muka; MSc. Enis Bellova	IKSHS/DAFSH	22.06.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
BEACTIVE – “EU4Youth – European Week of Sport beyond Borders in the Western Balkans”.	Dr. Elvira Baze MAS	IKSHS/DAFSH	22.06.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST

Sesion Shkencor: Kondicioni Fizik në Grupmosha të Ndryshme	Folës	Organizator	Data e zhvillimit	Pjesëmarrës
Matja dhe studimi i cilësisë së shpejtësisë dhe koordinimit së lëvizjes në ekstremitetet e poshtme dhe të sipërme me fëmijët e moshës 7 – 9 vjeç	Msc. Marsida Bushati Prof.Dr. Albert Karriqi	IKSHS/DPS	07.07.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
Efekti i stërvitjes plyometrike horizontale mbi VO2max dhe kapacitetin anaerobic	Msc. Arben Bici Prof.Dr. Agron Kasa	IKSHS/DPS	07.07.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
Performanca anaerobike e ekipit të “Partizanit” në basketboll femra	Msc. Migena Plasa Msc. Ledina Koci	IKSHS/DPS	07.07.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
Sporti si instrument terapeutik kundër depresionit	Msc. Artemis Bajaziti	IKSHS/DPS	07.07.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
Zhvillimi i shkathtësisë në tre disiplina sportive dhe krahasimi i tyre me normat Europiane	Msc. Anisa Nurja Msc. Enkelejda Muka	IKSHS/DPS	07.07.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST

Incidenca e përdorimit të duhanit në studentët e UST, krahasuar me një grup kontrolli	Msc. Suela Xufi Prof.Dr. Dhurata Bozo	IKSHS/DPS	07.07.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
---	--	-----------	------------	------------------------------

Sesion Shkencor Vjetor: Aktiviteti Fizik & Sporti	Folës	Organizator	Data e zhvillimit	Pjesëmarrës
“Impakti i qëndrueshmërisë specide në rritjen e performances fizike tek boksieret”	Msc. Marsida Bushati IKSHS	IKSHS	14.12.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
“Situatat kritike më të shpeshta që mund të çfaqen gjatë ushtrimit të aktivitetit fizik”	Prof.Asc.Dr. Linda Agolli, Dr.Genta Nallbani – FSHR	IKSHS	14.12.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
“Motivimi për ushtrimin e aktivitetit sportive te grupmoshat 16-18 vjeç”	Msc. Artemis Bajaziti IKSHS	IKSHS	14.12.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
“Krahasimi i niveleve të fitnesit kardio-respirator tek fëmijët e moshës 10 – 12 vjeç në zonat urbane dhe suburbane të qytetit të Tiranës”	Msc. Laureta Derhemi, Prof.Asc.Dr. Aida Beno FVFR	IKSHS	14.12.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
“Rëndësia e vazhdimësisë së rehabilitimit deri në fitness në trauma sportive”	Phd., PT Klejda Tani FSHR	IKSHS	14.12.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
“Dëmtimet më të shpeshta në sport dhe metodat për reduktimin e tyre”	M.Sc. Anisa Nurja Phd. Can., Prof. Dr. Dhurata Bozo, Msc. Suela Xhufi IKSHS	IKSHS	14.12.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
“Rehabilitimi i artikulacionit të gjurit pas rikonstruksionit kirurgjikal LBA”	M.Sc. Ana Sulaj – FSHR	IKSHS	14.12.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST

“Identifikimi dhe zhvillimi i talenteve në futbollin rekreativ”	Prof.Asc.Dr. Bashkim Delia – FVFR	IKSHS	14.12.2021	Pedagogë dhe Studentë të UST
---	-----------------------------------	-------	------------	------------------------------

Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka vënë në dispozicion të kërkimit shkencor laboratorët: laboratorin e biomekanikës dhe analizës së lëvizjes; laboratorin e fiziologjisë së ushtrimit dhe testimit funksional; laboratorin e biokimikës; laboratorin e rehabilitimit; laboratorin e vlerësimit koordinativ; laboratorin e vlerësimit të posturës; laboratorin e informatikës dhe një laborator për gjuhë dhe huaja, palestrën dhe sallën e dancit si dhe terrenet sportive në funksion të procesit akademik. Gjithashtu, në ndihmë të realizimit të synimeve të kërkimit shkencor janë biblioteka me fondin e materialeve të printuara dhe digjitale.

Duke analizuar veprimtarinë kërkimore të zhvilluar gjatë vitit akademik 2020-2021, arrijmë në përfundimin se duhet punuar për të përcaktuar fushat e projekteve të kërkimit; për të përcaktuar projektet konkrete të kërkimit në nivel departamenti dhe fakulteti.

Në këtë kuadër, shënojmë se lipset që kërkimi i studentëve të lidhet me projektet e kërkimit të departamentit, gjë që ende është një sfidë. Ky është një synim që do të jetë në fokus edhe në vitet që vijojnë derisa të arrijmë që të krijojmë traditën në këtë aspekt. Kështu studentët do të jenë të aftë të përfshihen në veprimtarinë reale kërkimore të UST-se.

Një aspekt tjetër ku duhet përqendruar veprimtaria në vitin e ardhshëm është përcaktimi në buxhetin vjetor dhe afatmesëm të një fondi gjithnjë në rritje për projektet e kërkimit shkencor dhe për mbështetjen e pjesëmarrjes së pedagogëve në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit.

VII. INFORMACION PËR PROGRAMET E STUDIMIT QË OFRON UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Programet e UST-se synojnë të përgatisin specialistë për fusha vitale, si: edukimit fizik dhe shëndetit, të rekreacionit, të shkencave sportive, të rehabilitimit e të mirëqenies fizike si dhe të menaxhimit të sporteve e turizmit aktiv.

Gjatë vitit 2020-2021, Universiteti i Sporteve të Tiranës ka ofruar 9 programe studimi, tre programe bachelor dhe tre programe master profesional dhe dy programe master shkencave. Të gjithë programet kanë status aktiv. (Shih tabelen)

Programi i studimit "Bachelor" në FSHL është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të

studimeve lëshohet “Diplomë “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes”. Misioni i programit “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e shkencave të lëvizjes dhe t’u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si specialistë të fushës në sektorin publik dhe privat. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si ato të teknikave dhe metodikat e disiplinave të ndryshme sportive , të njohjes së teknikave të përdorimit të formave, mjeteve e metodave të të mësuarit të veprimeve lëvizore, në përputhje me përvojën dhe karakteristikat e grupmoshave e gjinive të ndryshme në shkollë, të njohjes dhe përdorimit me kompetence profesionale të termave bazë të edukimit fizik e sportit, të njohjes së kurrikulës së lëndës së edukimit fizik, procesin mësimor dhe filozofinë bashkëkohore të zhvillimit të orës së mësimi, të legjislacionit të sportit dhe edukimit etj.

Programi i studimit “Bachelor në Shkencat e Veprimtarisë Fizike, Shëndetit dhe Rekreacionit” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Shkencat e Veprimtarisë Fizike, Shëndetit dhe Rekreacionit”. Misioni i këtij programi studimi është përgatitja e specialistëve me njohuri të përgjithshme në fushën e aktivitetit fizik dhe rekreacionit, duke mundësuar një karrierë të mëtejshme akademike ose profesionale në një nga specializimet e kësaj fushe studimi.

Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si ato të teknikave dhe metodikave të disiplinave të ndryshme që lidhen me Rekreacionin, Aktivitetin Fizik, Shëndetin e Turizmin, ku krahas formimit specifik në fushën e aktivitetit fizik dhe rekreacionit ofrohet edhe formim të përgjithshëm metodologjik e kulturor të studentëve.

Programi i studimit “Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit”. Misioni i programit “Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e rehabilitimit dhe t’u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si specialistë të fushës në sektorin publik dhe privat. Programi i ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Shkencat e Rehabilitimit” ka për qëllim të formojë rehabilitues fizikë dhe profesionistë me njohuri të thella për trupin e njeriut, për faktorët e ndryshëm që risin rrezikun për tu prekur nga sëmundje të ndryshme, llojet më kryesore të dëmtimeve dhe procesin e programimit dhe ndërtimit të një programi ushtrimor rehabilitues sipas nevojave specifike dhe diagnozës së çdo individi. Rehabilituesi fizik në fund të studimeve fiton njohuri dhe aftësi për të kryer një numur të konsiderueshëm teknikash rehabilituese dhe terapish të ndryshme si: radioterapi elektrotterapi, hidroterapi, masazhoterapi, kinezoterapi si dhe planifikim të programeve të rehabilitimit me anë të ushtrimeve. Gjithashtu rehabilituesi fizik në fund të studimeve “Bachelor” fiton kompetenca në zbatimin e planeve terapeutike që përcaktohen nga mjeku fizioterapist dhe mjekë të tjerë të specialiteteve të ndryshme. Studentët pas diplomimit janë të aftë të trajtojnë pacientë me probleme të ndryshme shëndetësore, duke e përshtatur terapinë rehabilituese ushtrimore në varësi të diagnozës dhe të gjëndjes së tyre individuale shëndetësore. Të diplomuarit në programin Bachelor

në "Shkenca të Rehabilitimit" do ti nënshtrohen kërkesave të profesionit me Kodin e Professionistit, 2264 si specialistë të tjerë të shëndetësisë me nivelin e katërt të kompetencës në ILKP përcaktuar në VKM Nr. 514 dt. 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar". Të diplomuarit në Bachelor në "Shkenca të Rehabilitimit" në bashkëpunim me specialistë të tjerë të kujdesit shëndetësor, janë punonjës të kujdesit shëndetësor në strukturat shëndetësore, publike ose private, ku ata ushtrojnë profesionin e tyre si rehabilitues fizik.

Programi i studimit "Master i Shkencave" në FSHL është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 2-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet "Diplomë Master i Shkencave në "Shkenca Sportive". Misioni i programit "Master i Shkencave" në "Shkenca Sportive" është të pajisë studentët me njohuritë e thelluara nevojshme në fushën e shkencave sportive dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë por edhe si studiues të fushës nepermjet aftësive të krijuara në kerkimin shkencor. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime të metejshme në fusha të tilla, si mjekësinë sportive dhe rehabilitimin sportiv. Gjithashtu ti pajisë studentët me njohuri të cilat lidhen me ndikimin e aktivitetit fizik në patologji të ndryshme mjekësore sipas grupmohave si dhe njohuri të thelluara në edukimin shëndetësor, higjienën dhe mënyrën e të ushqyerit, si dhe njohin mekanizmat dhe mënyrat e studimit shkencor etj.

Programi i studimit "Master i Shkencave në Aktivitet Fizik dhe Shëndet" është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 2-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet "Diplomë Master i Shkencave në Aktivitet Fizik dhe Shëndet". Misioni i programit "Master i Shkencave në Aktivitet Fizik dhe Shëndet" është të pajisë studentët me njohuritë e thelluara nevojshme në fushën e aktivitetit fizik dhe shëndetit dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë por edhe si studiues të fushës nepermjet aftësive të krijuara në kerkimin shkencor. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime të metejshme në fusha të tilla, si Kërkimi Shkencor, Biomotorikë, Kineziologji, Fiziologji, Training (Training i Kondicionit, Core-Training etj), Aktiviteti Fizik në Lojrat Sportive/Individuale etj.

Programi i studimit "Master Profesional" në FSHL është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 2-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet "Diplomë Master Profesional në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar". Misioni i programit "Master Profesional në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar" është të pajisë studentët me njohuritë e thelluara të nevojshme në fushën e edukimit fizik, sportit dhe shëndetit dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë nepermjet aftësive profesionale specifike të krijuara në përfundim të programit. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon përgatitje profesionale specifike në fusha të tilla, si planifikim dhe organizim i procesit mësimor si dhe i veprimtarive kurrikulare dhe ekstrakurrikulare me nivel të lartë të shprehive metodike për disiplina të ndryshme sportive, zbaton teknikat e kërkimit shkencor në

drejtim të rritjes profesionale si dhe të menaxhojë me kompetencë dhe etikë profesionale orën e mësimi etj.

Programi i studimit "Master Profesional në FSHL në "Trajner i përgatitjes fizik" është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 60 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 1-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet "Diplomë Master Profesional në "Trajner i përgatitjes fizike".

Misioni i programit "Master Profesional në "Trajner i përgatitjes fizik" është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme në fushën e përgatitjes fizike dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë nepermjet aftesive profesionale specifike të krijuara në përfundim të programit. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon përgatitje profesionale specifike në fusha të tilla, si përgatitja fizike e sportistëve dhe trajnerëve , etj.

Programi i studimit "Master Profesional në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi" është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 60 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 1-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet "Diplomë Master Profesional në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi". Misioni i programit "Master Profesional në Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi" është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme në fushën e Aktivitetit Fizik, Rekreacionit, Fitnesit dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë nepermjet aftesive profesionale specifike të krijuara në përfundim të programit. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon përgatitje profesionale specifike në fusha të tilla, si Terapia e Lëvizjes, Training Personal, Menaxhim i Aktivitetit Fizik, Metodologjia e Sporteve Individuale Rekreative/Lojrave Sportive Rekreative etj.

Programi i studimit "Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm" është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 60 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 1-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet "Diplomë Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm". Misioni i programit "Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm" është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme në fushën e Menaxhimit të Sportit e Turizmit dhe t'u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë nepermjet aftesive profesionale specifike të krijuara në përfundim të programit. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon përgatitje profesionale specifike në fusha të tilla, si Politika Menaxhimi në Sport e Turizëm, Marketing, Menaxhim, Qeverisje e Sportit, Menaxhim/Organizim Aktivitetesh, etj.

Nga analiza e veprimtarisë së fakulteteve në fushën e kurrikulave, rezultojnë se tipari i përgjithshëm i veprimtarisë së Fakulteteve ka qenë konsolidimi i programeve që ofrojnë duke u përqendruar në përmirësimin e kurrikulave dhe të programeve mësimore të lëndëve si dhe pasurimi i ofertës akademike me programe të reja studimi.

Ofrimi i programeve cilësore të studimit është një nga synimet kryesore të UST-se. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2020-2021, nën drejtimin e Senatit Akademik u ndërmorën një sërë procesesh të cilat realizuan një sërë përmirësimesh të programeve të studimit brenda. Qëllimi i këtyre përmirësimeve ishte sigurimi i përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë të programeve të studimit.

Duke u bazuar në: Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 35 pika 9; në VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, pika 1, 2, 2.1, shkronja a, b, c, ç, d, dh, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.8, 2.9; Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, kreu II, pika 2, 6, 7; Senati Akademik ndërmori një sërë vendimesh të renditura më poshtë për të mundësuar realizimin e ndryshimeve të programeve, dhe përmirësimin e programeve mësimore të lëndëve:

Fakultetet dhe departamentet realizuan gjithë procesin në përputhje me vendimet e miratuara. Senati Akademik miratoi ndryshimet sipas legjislacionit në fuqi.

Përmirësimet e ndërmarra sollën një vlerë të shtuar të pasqyruar në:

- optimizimin e strukturës së kurrikulës.
- vendosjen e balancës më të mirë sipas përqindjeve të kërkuara për lëndët sipas kategorive;
- përmirësimin e shpërndarjes së krediteve;
- optimizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik, krahasuar me ngarkesat e viteve të kaluara;
- përmirësimin e programeve mësimore të lëndëve.

Në nëntor 2020-2021, Universiteti i Sporteve të Tiranës përgatiti paketën me dy programe të reja studimi të ciklit të trete dhe dy programe studimi të ciklit të dyte të cilat i paraqiti në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Programe studimi të ciklit të trete

- Program Studimi “Doktorate në “Shkenca Sportive”(si riorganizim)
- Program Studimi “Doktorate në Aktivitet Fizik dhe Shëndet” (si riorganizim)

Programe studimi të ciklit të dytë

- Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor”(si riorganizim)
- Master i Profesional në “Trajner i përgatitjes fizike“ (si program që hapet për herë të parë)

Ministria e Arsimit dhe Sportit deri tani ka miratuar vetëm Programin Master Profesional në “Trajner i përgatitjes fizike“ ndërsa programet e tjera kanë kaluar fazën e parë të miratimit dhe janë në proces.

Aplikimi për këto programe u bë me synimin që të zgjerohej oferta akademike dhe të krijoheshin mundësitë e kualifikimit të stafit aktual në programin e ciklit të tretë, njëkohësisht kjo strategji shoqërohet edhe me rritjen e numrit të studentëve të UST-së.

Konsolidimi i programeve ekzistuese dhe ofrimi i programeve të reja do të jetë në fokus edhe për vitin e ardhshëm akademik. Pasurimi i ofertës akademike me programe të reja do të orientohet drejt programeve unike dhe programeve të ciklit të dytë dhe programeve të përbashkëta me universitet e huaja partnere. Mendohet se në këtë mënyrë do të mundësohet rritja e numrit të studentëve, do të mundësohet ndryshimi i statusit të Universitetit në tregun akademik kombëtarë e rajonal si dhe do të mundësohet një qasje me kosto më efektive.

TABELA 12: PROGRAMET E STUDIMIT

PROGRAMET E STUDIMIT 2020-2021						
FAKULTETI SHKENCAVE TE LEVIZJES						
Nr.	Programi i studimit	Kredite	Leja për hapjen	Statusi	Vendimi i akreditimit ose riakreditimit	Vlefshmëria e akreditimit
1	Bachelor në "Shkencat e lëvizjes"	180	Urdhër nr. 515, datë 30.06.2010	Aktiv	Vendim nr.29, datë 14.05.2020	13.05.2026
2	Program i ciklit të tretë në fushën e "Shkencave sportive"	180	Urdhër NUK KA PATUR VKM Nr. 768, datë 02.11.20211 VKM Nr. 24, datë 09.01.2013 "Për miratimin e kuotave të pranimit....."	Pasiv	N/A	N/A
3	Master i Shkencave në "Shkencat Sportive"	120	Urdhër nr.683, datë 25.08.2010	Aktiv	Vendim nr.20, datë 19.02.2021	30.09.2023
4	Master Profesional në "Mesuesi në Edukimin Fizik e Shëndetsor në arsimin parauniversitar"	120	Urdhër nr.15, datë 11.01.2018	Aktiv	Vendim nr.31, datë 14.05.2020	13.05.2026
5	Master Profesional në "Trajner i përgatitje fizike"	60	Urdhër nr.355, datë 17.09.2021.	Aktiv	N/A	
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT						
Nr.	Programi i studimit	Kredite	Leja për hapjen	Statusi	Vendimi i akreditimit	Vlefshmëria e akreditimit
5	Bachelor në "Fushat e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit"	180	VKM Nr. 515, datë 30.06.2010	Aktiv	Vendim Nr. 30, datë 14.05.2020	13.05.2026
	Program i ciklit të tretë në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"	180	N/A	Pasiv	N/A	N/A
6	Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"	120	Urdhër Nr. 48, datë 05.02.2015	Aktiv	Vendim Nr. 19, datë 19.02.2021	30.09.2024
7	Master Profesional në "Menaxhim në Sport dhe Turizëm"	60	Urdhër Nr. 395, datë 05.09.2017	Aktiv	Vendim Nr.25, datë 13.07.2018	30.09.2023
8	Master Profesional në "Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi"	60	Urdhër Nr. 51, datë 05.02.2015	Aktiv	Vendim Nr. 18, datë 09.02.2021	30.09.2026
FAKULTETI I SHKENCAVE TE REHABILITIMIT						
Nr.	Programi i studimit	Kredite	Leja për hapjen	Statusi	Vendimi i akreditimit	Vlefshmëria e akreditimit
9	Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit	180	Urdhër nr. 495, datë 11.10.2019	Aktiv	Viti i dytë i ofrimit të programit	N/A

VIII. NDRYSHIMET NË BAZËN RREGULLATORE TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Gjatë vitit akademik 2020-2021 u bënë përmirësime në dokumentacionin rregullator të UST-se. Dokumentacioni u pasurua me dokumente e akte rregullative të paraqitura së pari ose të ripunuara tërësisht. Këto dokumente ndihmojnë në rregullimin e veprimtarisë drejtuese, të sigurimit të cilësisë, të bibliotekës dhe të procesit të transferimit të studentëve.

TABELA 13: NDRYSHIME NË DOKUMENTET RREGULLATORE TË UST-së

Emërtimi i dokumentit	Organi i miratimit	Numri i dokumentit	Data e miratimit	Statusi i dokumentit (i ri/i ripunuar)
Kodi i Etikës	Senati	57	15.12.2021	I ri
<ul style="list-style-type: none"> Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional së bashku me Planin e Veprimtimit afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë. Strategjia për ndërkombëtarizimin e UST 	Senati	44	19.04.2021	I ri
Amendimi i Statutit	Senati	138	24.11.2021	I ripunuar
<ul style="list-style-type: none"> Aplikimi i programeve të doktoratës FSHL & FVFR Rregullore e doktoraturës FVFR Rregullore e doktoraturës FSHL 	Senati Senati Senati	77 78	29.04.2021 29.04.2021	I ri I ri
Rregullore e UST	Senati	38	30.03.2021	I ripunuar
Rregullore e FVFR + Dep	Senati	48	19.04.2021	I ripunuar
Rregullore e FSHR + Dep	Senati	49	19.04.2021	I ri
Rregullore e IKSHS + Dep	Senati	50	19.04.2021	I ripunuar
Rregullore e FSHL + Dep	Senati	59	23.04.2021	I ripunuar
Rregulloret e prog.stud. FVFR	Senati	60	23.04.2021	I ripunuar
Rregulloret e prog.stud. FSHR	Senati	61	23.04.2021	I ripunuar
Rregulloret e prog.stud. FSHL	Senati	62	23.04.2021	I ripunuar
Rregullore e provimeve	Senati	56	19.04.2021	I ripunuar
Rregullore e diplomimit	Senati	56	19.04.2021	I ripunuar
Rregullore e rekrutimit për të gjitha nivelet dhe llojet e rekrutimit apo lëvizjet paralele në UST	Senati	65, 66	23.04.2021	I ri
Rregullore e Administratës	Senati	67	23.04.2021	I ripunuar
Rregullore e Bibliotekës	Senati	54	19.04.2021	I ripunuar
Rregullore e Njësive të Sigurimit të Cilësisë	Senati	46	19.04.2021	I ri
Dokumenti i politikave të cilësisë dhe instrumentet e vlerësimit	Senati	46	19.04.2021	I ri
Rreg. e Njësive të Zhvillimit Kurrikulave	Senati	52	19.04.2021	I ri
Rregullore e funks KPPA	Senati	5	22.01.2021	I ri

Paketa rregullative e KPPA	Senati	45	19.04.2021	I ri
Rregullore e Këshillave Studentore	Senati	53	19.04.2021	I ripunuar
Rregullore e transferimit të studimeve	Senati	57	19.04.2021	I ripunuar
Rregullore e praktikave mësimore	Senati	63	23.04.2021	I ripunuar
Rregullore e Sekretarisë Mësimore	Senati	55	19.04.2021	I ripunuar
Rregullore e Njesisë Përgjegjëse për Sinjalizimin	Senati	120	14.10.2021	I ri
Strategjia e Kërkimit Shkencor	Senati	47	19.04.2021	I ri

1. *Statuti i institucionit* u ripunua për ta sjellë në përputhje me realitetin strukturor të institucionit pas miratimit dhe futjes në funksionalitet të njësisë së katërt kryesore.
2. *Plani i Zhvillimit Strategjik të Institucionit* u hartua dhe miratua plani i zhvillimit të institucionit si një dokument strategjik duke patur parasysh platformën e paraqitur në fushatën zgjedhore të Prof.Dr. Agron Kasa i cili u votëbesua dhe u mandatua për të implementuar këtë platform zhvillimore.
3. *Rregullore e Institucionit* u ripunua, pasi nuk përfaqësonte ndryshimet strukturore dhe legjislative të ndodhura në institucion. Kjo rregullore përcakton rregulla për organizimin, funksionimin, vendimmarrjen, zbatimin e vendimeve dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e institucionit.
4. *Kodi etikës* u hartua si një dokument i cili do të shërbejë për mbarëvajtjen e institucionit por edhe si një bazë për referim nga ana e Këshillit të Etikës në punën e tyre.
5. *Rregulloret e njësive kryesore, të njësive bazë dhe të programeve të studimit* u rishikuan duke reflektuar ndryshimet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
6. *Politika e Sigurimit të Cilësisë* është dokument i paraqitur së pari dhe i miratuar nga Senati Akademik i UST-së , i cili shërben për të udhëhequr vendimet dhe për të orientuar procesin e sigurimit të cilësisë së veprimtarisë së gjithanshme të institucionit. Ky dokument përmban parime për menaxhimin e cilësisë, standarde për sigurimin e brendshëm të cilësisë, qëllimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, fushat dhe qasjet e vlerësimeve në kuadrin e sigurimit të cilësisë, elementet që garantojnë cilësinë, veprimtarinë monitoruese, vlerësuese dhe të përmirësimit, mënyrat e komunikimit dhe publikimit të rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe të akreditimit.
7. *Rregullore e Sigurimit të Cilësisë*. Kjo Rregullore ka si objekt përcaktimin e rregullave, procedurave dhe mekanizmave për sigurimin e cilësisë në UST, përcakton rolin dhe përgjegjësitë e organeve dhe autoriteteve drejtuese, të strukturave akademike dhe administrative, të organizmave të posaçme për sigurimin e cilësisë. Kjo Rregullore synon të mandatojë dhe të garantojë mbështetjen, sigurimin dhe arritjen e cilësisë, vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë, sigurimin e një evidence për të gjithë të interesuarit për nivelin e cilësisë së arritur nga UST-ja.

8. *Rregullore e Bibliotekës* u ripunua tërësisht me synimin për të përcaktuar më qartë dhe më mirë qëllimin, veprimtarinë, të drejtat dhe detyrimet e bibliotekës dhe të përdoruesve të materialeve bibliotekare në përputhje me zhvillimet e institucionit.
9. *Rregullore e Transferimeve*. Kjo rregullore është hartuar mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, në Statutin e UST-se në përputhje me kërkesat e Procesit të Bolonjës. Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat e transferimit të studimeve nga programe studimi të fushave të njëjta ose të përafërta të të njëjtit cikël studimi; të transferimit të studimeve nga Institucione të Arsimit të Lartë (më poshtë IAL) vendase ose të huaja, publike ose jopublike në Universitetin e Sporteve të Tiranës (më poshtë UST); të transferimit të studimeve brenda UST-se.
10. *Rregulloret komisioneve të përhershme të SA* dokumenta të cilat kerkohen për funksionalitetin e këtyre komisioneve të cilat u krijuan rishtas pavarësisht se ishin të parashikuara si të tilla në Statutin e miratuar të institucionit.
11. *Rregullore e instrumenta rregullative të tjera në funksion të plotësimit të të gjithë kuadrit legjislativ të institucionit sipas listës së paraqitur në tabelën më sipër.*

Plotësimi i paketës rregullatore me dokumente të tjera të parashikuara edhe në Planin Strategjik të Zhvillimit është objektiv edhe për vitet e ardhshme akademike.

IX. INFORMACION PËR ANGAZHIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka një trupë akademike e cila është përmirësuar cilësisht gjatë vitit akademik 2020-2021.

Gjatë këtij viti akademik ndodhën përmirësime dhe lëvizje në dy nivele:

- a) në nivelin e njësive kryesore u mandatuan drejtuesit e dy fakulteteve;
- b) në nivelin e njësive bazë u larguan dy pedagogë dhe u mandatuan pesë drejtues të departamenteve, dy prej të cilave u hapën rishtas ndërsa dy të tjera erdhën si rezultat i ristrukturimit të atyre ekzistuese. Trupa akademike e angazhuar gjatë vitit akademik 2020-2021 ka këto karakteristika kryesore.

Pedagogë me kontribute të spikatura. Në Universitetin e Sporteve të Tiranës japin mësim pedagogë me formim nga fusha studimi të lidhura me edukimin fizik, sportin, rekreacionin, shëndetin, rehabilitimin dhe menaxhimin e sporteve dhe turizmin; pra ata vijnë nga një spektër i gjerë; të njohur për kontribute në mësimdhënie në arsimin e lartë, në kërkimin shkencor dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

Pedagogë me ekspertizë nga bota reale. Universiteti i Sporteve të Tiranës ka pedagogë me përvojë nga bota reale. Mbi 73% e tyre sjellin përvojën e gjatë dhe të pasur nga bota e sportit, shëndetit, biznesit, menaxhmentit, administratës publike, arsimit, organizatave dhe kompanive të ndryshme. Ata e

ndërthurin teorinë me shembujt e përvojës nga bota reale dhe lidhjet e tyre mund t'u sigurojnë studentëve mundësi të vlefshme për profesionin dhe rrjetet profesionale.

Pedagogë me formim dhe përvojë që përputhet me fushën e programit dhe lëndët mësimore. Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Ky është një tregues që u përmirësua gjatë vitit akademik 2020-2021, duke bërë riorganizimin e personelit nëpër departamente dhe duke rekrutuar pedagogë, formimi dhe përvoja e të cilëve përputhen mirë me lëndët mësimore të programit të studimit, me kërkesat për veprimtaritë laboratorike dhe drejtimin e praktikës profesionale.

Mësimdhënie e nivelit të lartë. Pedagogët e UST-se kanë manifestuar një përkushtim të veçantë për të organizuar të nxënit e studentëve, bazuar në qasjen me në qendër studentin. Njohuritë, përvoja dhe përkushtimi i personelit akademik, të kombinuara me punën e studentëve, mbështesin zhvillimin e tyre si në aspektin akademik ashtu edhe personal. Kjo i ndihmon studentët që të jenë gati për fitimin e diplomës dhe vazhdimin e studimeve të mëtejshme ose të futen në botën e punës.

Raporti studentë-pedagog. Me një raport studentë – pedagog në UST afersisht 15:1, studentët njohin personalisht pedagogët. Pedagogët nuk janë vetëm mësimdhënës, por janë, gjithashtu, këshilltarë dhe mentorë të besuar. Ata madje mund të ndihmojnë studentët të kryejnë projektin kërkimor - një mundësi kjo që nuk ofrohet kudo për studentët universitarë. Studentët marrin vëmendjen që u nevojitet për të arritur sukses në shkallën më të lartë.

Personel ndërkombëtar. Universiteti i Sporteve të Tiranës ka ftuar personel akademik ndërkombëtar që ofron një ekspertizë ndërkombëtare në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Të studiosh me pedagogë cilësorë, të përfitosh nga përvoja e pedagogëve me karrierë të gjatë në mësimdhënie, kërkime dhe me kontribut social është garanci për cilësinë e studimeve.

Tabela 14: TË DHËNA MBI PERSONELIN AKADEMIK E ADMINISTRATIV TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS - DHJETOR 2021

Universiteti i Sporteve të Tiranës	Pedagog me kohë të plotë e staf ndihmes administrativ					
	Profesor	Prof. Asc	Lektor	As/Lektor	Gjithsej	Nd/akademik me karakter mësimor
Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	6	9	13	9	37	6
Dekanati ndihmes akademik e administrativ						1
Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit	4	2	7	3	16	1
Departamenti i Sporteve Kolektive	0	3	3	4	10	2

Departamenti i Sportive Individuale	2	4	3	2	11	2
Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	1	5	9	15	30	5
Dekanati ndihmes akademik e administrativ						1
Departamenti i Aktivitetit Fizik, Rekre. dhe Turizmit	0	2	3	6	11	2
Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit	1	1	4	3	9	1
Departamenti i Levizjes dhe Shendetit	0	2	2	6	10	1
Fakulteti i Shkencave të Reabilitimit	1	2	5	6	21	3
Dekanati ndihmes akademik e administrativ						1
Departamenti i Disiplinave Biomjekësore dhe Humane	1	0	3	3	7	1
Departamenti i Kineziologjisë	0	2	2	3	7	1
Departamenti i Reabilitimit	Dep. Reabilitimit është planifikuar që të plotësohet me 7 anëtarë në qershor të vitit 2022					
Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit	3	3	3	12	21	4
Drejtori ndihmes akademik e administrativ						1
Departamenti Persormancës Sportive	1	2	0	4	7	1
Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndeti	2	1	0	4	7	1
Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë	0	0	3	4	7	1
Staf ndihmës akademik me karakter Administrativ						34
Staf administrative në varësi të Administratorit						25
Gjithsej FSHL+ FVFR+ FSHR+IKSHS+ Nd/Akademik dhe Administrata						186

Struktura ndihmës akademike në administratë	34
Struktura administrative	25
Struktura ndihmës akademike në njësitë kryesore	18

Cilësia e personelit akademik është përmirësuar me rekrutimet e pedagogëve me tituj akademikë dhe grada shkencore dhe ekspertizë të dalluar në fushën e tyre respektive. Ky është një tregues që përcakton UST-se në pozicionin më të mirë në treg dhe gjithashtu përmbush plotësisht standardet shtetërore të cilësisë.

Duke analizuar strukturën e njësive bazë sipas kategorive, vërejmë se personeli akademik me kohë të plotë përbëhet nga këto kategori 11 profesorë, 19 profesorë të asociuar, 30 lektorë, 42 asistent-lectorë; ndërsa personeli akademik me kohë të pjesshme përbëhet nga kategoritë 0 profesorë, 4 profesorë të asociuar, 5 lektorë dhe 13 asistent-lectorë. Në total janë 11 kategoritë profesorë, 23 profesorë të asociuar, 35 lektorë dhe 55 asistent-lectorë. Pra, personeli akademik i brendshëm me tituj dhe grada përbën 70% krahasuar me personelin e kategorisë asistent-lector, që përbën 30%. Personeli akademik i jashtëm me tituj dhe grada përbën 31% krahasuar me personelin e kategorisë asistent-lector, që përbën 69%. Ky është një tregues pozitiv, por që duhet të përmirësohet në vitet në vijim, duke shtuar numrin e pedagogëve me grada dhe tituj, veçanërisht për të përmirësuar raportin e pedagogëve të brendshëm me tituj dhe grada. Gjithashtu, duhet plotësuar struktura e Departamenteve të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, që të plotësojnë kriterin minimal të kërkuar nga Ligji i AL 80/2015.

Tabelat që paraqiten më poshtë përmbajnë të dhëna për personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve.

TABELA 15: TABELË PËRMBLEDHËSE ME TË DHËNA SASIORE DHE CILËSORE TË PERSONELIT AKADEMIK PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

FAKULTETI I VEPRIMTARISE FIZIKE DHE REKREACIONIT

Departamenti	Prof. Dr.	Prof. Asoc. Dr.	Lektor	Asistent- lektor	F	M	PAE	Prof. Dr.	Prof. Asoc. Dr.	Lektor	Asistent- lektor	F	M	PAK	FTUAR	Total
Dep. i Ed. Shëndetit	4	2	7	3	8	8	16	0	1	0	1	0	2	2	0	18
Dep. i Sport. Kolektive	0	2	3	4	3	6	9	0	0	0	5	1	4	5	0	14
Dep. i Sport. Individuale	2	4	3	2	3	8	11	0	0	0	0	0	0	0	0	11
Total	6	8	13	9	14	22	36	0	1	0	6	1	6	7	0	43

FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

Departamenti	Prof. Dr.	Prof. Asoc. Dr.	Lektor	Asistent- lektor	F	M	PAE	Prof. Dr.	Prof. Asoc. Dr.	Lektor	Asistent- lektor	F	M	PAK	FTUAR	Total
Dep. i Akt. Fiz, Rekreacion dhe Turiz.	0	2	3	5	3	7	10	0	2	1	2	0	5	5	0	15
Dep. i Menaxh. Sp. Turiz	1	0	4	2	2	5	7	0	0	2	2	2	2	4	0	11
Dep. i Lëv. Shënd.	0	2	2	5	4	5	9	0	0	1	1	1	1	2	0	11
Total	1	4	9	12	9	17	26	0	2	4	5	3	8	11	0	37

FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT

Departamenti	Prof. Dr.	Prof. Asoc. Dr.	Lektor	Asistent-lektor	F	M	PAE	Prof. Dr.	Prof. Asoc. Dr.	Lektor	Asistent-lektor	F	M	PAK	FTUAR	Total
Dep.i Dis. Biomj. Hum.	1	0	3	3	3	4	7	0	0	1	2	2	1	3	0	10
Dep. Kinezio.	0	2	2	3	6	1	7	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Dep. i Rehab.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	1	2	5	6	9	5	14	0	0	1	2	2	1	3	0	17

INSTITUTI I KËRKIMIT SHKENCOR

Departamenti	Prof. Dr.	Prof. Asoc. Dr.	Lektor	Asistent-lektor	F	M	PAE	Prof. Dr.	Prof. Asoc. Dr.	Lektor	Asistent-lektor	F	M	PAK	FTUAR	Total
Dep. i Perf. Sport.	1	2	0	4	4	3	7	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Dep.Akt .Fiz dhe Shënd.	2	1	0	4	4	3	7	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Dep.Projekt. dhe Tekno.	0	0	2	4	2	4	6	0	0	0	0	0	0	0	0	6
Total	3	3	2	12	10	10	20	0	0	0	0	0	0	0	0	20
Totale UST	11	17	29	39	42	54	96	0	3	5	13	6	15	21	0	117

X. INFORMACION PËR VEPRIMTARINË E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Universiteti i Sporteve të Tiranës është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Për kryerjen e kësaj detyre, Universiteti i Sporteve të Tiranës ka ngritur një strukturë në nivel institucioni e cila mbështetet nga strukturat analoge në njesite kryesore dhe baze të institucionit. Kjo njësi është emërtuar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni është një strukturë ndihmës-akademike që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi bashkëpunon me Komisionin e Përhershëm të SA përgjegjës për Sigurimit të Cilësisë dhe është në varësi të Rektorit të UST-se.

Kjo njësi ka si mision të planifikojë, të drejtojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë e kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi. Kjo njësi luan një rol të rëndësishëm në krijimin e kulturës së cilësisë që ndikon të arrijë dhe të ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese të UST-së.

Veprimtaria e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë gjatë vitit akademik 2020-2021 është mbështetur me dy dokumente të miratuara nga Senati Akademik, Politika e Sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloret e Sigurimit të Cilësisë. Në këtë kuadër është përgatitur paketa me instrumente të vlerësimit për vlerësimin e mësimdhënies, për vlerësimin e veprimtarisë së departamenteve, për vlerësimin nga kolegët, për vlerësimin e punëdhënësve.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka vlerësuar, periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në fund të çdo semestri apo para sesionit të provimeve organizon vlerësimin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Duke filluar nga viti 2021 kjo njësi ka organizuar edhe vlerësimin studentor për veprimtarinë e departamenteve.

Gjatë vitit akademik 2020-2021, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u angazhua tërësisht në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të riakreditimit periodik institucional si dhe në organizimin e Sondazhit të Studentëve.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me Drejtorin e ngarkuar për marrëdhëniet me Studentët kryen studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga UST.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka përgatitur raporte për vlerësimin e mësimdhënies së pedagogëve nga studentët dhe rezultatet e tyre ua ka përcjellë individualisht pedagogëve. Raportet e vlerësimit të pedagogëve dhe të departamenteve u janë vënë në dispozicion drejtuesve të fakulteteve dhe të departamenteve.

Rezultatet e vlerësimit janë përdorur si burim për përmirësimin e cilësisë dhe si burim për vlerësimin e jashtëm.

Bazuar në analizën e veprimtarisë së Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, kërkohet që kjo njësi të organizojë më mirë informimin e studentëve dhe të publikut për sigurimin e cilësisë, duke përgatitur buletine informative dhe duke paraqitur informacione në faqen zyrtare të UST-se.

XI. INFORMACION PËR STUDENTËT

Numri i studentëve është një çështje komplekse pasi është qellimi kryesor i ekzistencës së një IAL-je. Gjatë vitit akademik 2020-2021, në vitin e parë janë regjistruar si më poshtë:

FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

- "Bachelor", janë regjistruar 150 studentë, ndërsa u diplomuan 162 studentë;
- "Master Profesional", janë regjistruar 150, studentë ndërsa u diplomuan 162 studentë;
- "Master Shkencor", janë regjistruar 11 studentë, ndërsa u diplomuan 2 studentë.

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACION

- "Bachelor" janë regjistruar 164 studentë, ndërsa u diplomuan 138 studentë;
- "Master Profesional" Menaxhim Sport Turizëm, janë regjistruar 31 studentë, ndërsa u diplomuan 28 studentë;
- "Master Profesional" Trajner – Fitnesi, janë regjistruar 24 studentë ndërsa u diplomuan 19 studentë;
- "Master Shkencor" janë regjistruar 15 studentë, ndërsa u diplomuan 12 studentë.

FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT

- "Bachelor" janë regjistruar 25 studentë.

Nisur nga vlerësimi i shifrave mbi regjistrimet në vitet e para për programet e studimit me kohë të plotë, edhe për këtë vit akademik, vihen re dukuritë e mëposhtme.

Së pari, megjithatë situata paraqitet e kënaqshme me regjistrimin e studentëve. Lidhur me sfidën e rekrutimit të studentëve, kur konkurrenca për studentë është rritur, këto janë alternativat për të cilat duhet të punojë UST-ja: rritja e numrit të studentëve hapja e programeve të reja unike, rritja e numrit të studentëve të ciklit të dytë dhe tërheqja e studentëve ndërkombëtarë.

Së dyti, cilësia e studentëve është një tregues tjetër i rëndësishëm. Cilësia fiziko-teknike në hyrje e studentëve është e kontrolluar dhe certifikuar për shkak të testit pranues për në programet bachelor, por studentët që zgjedhin këto programe në kapacitete të tyre akademike lenë për teeshiruar gjë e cila reflektohet në vështirësitë që në hasim për formimin e tyre akademik në mënyrë cilësore.

Së treti, është ruajtur në çdo vit akademik kuotat për përfaqësimin e studentëve të cilët vijnë nga hapësira gjeografike të rajoneve jashtë kufijve zyrtarë Shqiptarë si dhe nga kuotat për kategoritë e veçanta shoqërore të vulnerabile.

Shtimi i numrit të studentëve dhe tërheqja e studentëve më cilësorë do të mundësohet me një veprimtari më intensive për përmirësimin e imazhit të UST-se me një strategji më inteligjente dhe me të efektshme marketingu, me ofrimin e programeve unike të studimit dhe përmirësimin e cilësisë së personelit akademik. Në këtë kontekst do të ndërtojmë një faqe të dedikuar interneti të universitetit ku kandidatët të gjejnë në mënyrë shterruese informacionin që ju duhet për të përzgjedhur programin e studimit.

Ndërsa përmirësimi i cilësisë gjatë studimeve do të arrihet nga një angazhimin më i madh i fakulteteve, departamenteve dhe i pedagogëve për të punuar fort në mënyrë të individualizuar me studentët dhe me përmirësimin e shërbimeve të tjera për studentët.

TË DHËNA STATISTIKORE PËR STUDENTËT

TABELA 16: TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR STUDENTËT

TË DHËNA STATISTIKORE PËR STUDENTËT PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021									
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	Studentë të regjistruar				Studentë kalues	Studentë të diplomuar	Studentë të çregjistruar	Studentë të transferuar	Studentë të shkëlqyer
	Total	Viti I	Viti II	Viti III					
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES									
"Bachelor" në fushat e Shkencave të Lëvizjes	488	165	157	166	464	162	5	3	5
"Master Shkencor" në fushat e Shkencave Sportive	14	11	3	-	11	2	0	0	0
"Master Profesional" në fushat Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar	333	174	159	-	289	145	8	0	9
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT									
"Bachelor" në fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit dhe të Rekracionit	509	184	162	163	440	138	8	1	3
"Master Shkencor" në fushat e Aktivitetit Fizik e Shëndetit	30	17	13	-	25	12	2	0	5

"Master Profesional" në fushat e Aktivitetit Fizik Rekreacion – Trajner Fitnessi	24	24	-	-	19	19	5	0	0
"Master Profesional" në fushat Menaxhim Sport e Turizëm	32	32	-	-	28	28	4	0	0
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT									
"Bachelor" në fushat e Shkencave të Rehabilitimit	25	25	0	0	23	0	0	0	1

TABELA 17: TË DHËNA PËR PËR NUMRIN E STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSA, REDUKTIM TË TARIFËS SË SHKOLLIM DHE QË PËRJASHTOHEN NGA PAGESA E TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Nr.	Programe Studimi	Numri i studentëve për vitin akademik 2020-2021 që kanë përfituar bursë		Numri i studentëve që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit			
		Bursë e plotë sipas kriterëve Ekonomiko Sociale	Bursë e plotë për student Ekselent	Reduktim i tarifës së shkollimit sipas kriterëve ekonomike (C.II) dhe me mesatare mbi 6(C.I)	Reduktim i tarifës së shkollimit sipas kriterit të ekselencës	Përjashtuar nga pagesat e tarifës së shkollimit sipas kriterëve Ekonomiko Sociale	Përjashtuar nga pagesat e tarifës së shkollimit sipas kriterit të ekselencës
I	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES						
1	"Bachelor" Në Fushat, Shkencat e Lëvizjes	36	5	342		57	5
2	"Master Shkencor" në Fushat Shkencat Sportive	-		1	0		
3	"Master Profesional" në Fushat Mësuesi Në Edukimin Fizik E Shëndetësor Në Arsimin Parauniversitar	-		28	9		
II	FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACION						
1	"Bachelor" Në Fushat e Veprimtarisë Fizike Të Shëndetit Dhe Të Rekreacionit	46	3	316		65	3
2	"Master Shkencor" Në Fushat E Aktivitetit Fizik E Shëndetit			0	5		
3	"Master Profesional" Në Fushat E Aktivitetit Fizik Rekreacion – Trajner Fitnessi		-	1			
4	Menaxhim Në Sport e Turizëm		-	2			
III	FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT						
1	"Bachelor" Në Fushat Shkencat E Rehabilitimit	2	1	22		2	1
		84	9	712	14	124	9

TABELA 18: TË DHËNA PËR KALUESHMËRINË DHE NOTËN MESATARE TË STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2020– 2021

FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES					
Nr.	Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total		Nota mesatare për numrin total të studentëve
1	Bachelor në "Shkencat e lëvizjes"	488	95%		6.8
2	Master Profesional në "Mësuesi në edukimin fizik dhe shëndetësor në arsimin parauniversitar"	333	95.7%		7.5
3	Master i Shkencave në "Shkenca Sportive"	11	100%		7.6
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT					
Nr.	Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total Të paraqitur / Gjithsej		Nota mesatare për numrin total të studentëve
4	Bachelor në "Fushat e Aktivitetit Fizik, Shëndetit e Rekreacionit"	509	95%	90%	6.7
5	Master Profesional në "Menaxhim në Sport dhe Turizëm"	32	100%	86%	8.0
6	Master Profesional në "Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni -Trajner Fitness"	24	100%	79%	8.2
7	Master i Shkencave në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet"	30	100%	98%	8.4
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT					
8	Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit"	25	92%		6.64

TABELA 19: TË DHËNA PËR PUNËSIMIN E STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021

FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES				
Nr.	Programi i studimit	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
1	Bachelor në "Shkencat e Lëvizjes"	162	40	60
2	Master i Shkencave në "Shkencat Sportive"	2	-	2
3	Master Profesional në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar"	145	80	35

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT				
Nr.	Programi i studimit	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
4	Bachelor në "Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndeti dhe të Rekreacionit"	138	60	45
5	Master i Shkencave – Fusha "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"	12	5	5
6	Master Profesional – Fusha Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi"	19	15	0
7	Master profesional në "Menaxhim në Sport dhe Turizëm"	28	12	10
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT				
Nr.	Programi i studimit	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
8	Bachelor në "Shkencat e Rehabilitimit"	0	0	0

Në UST konform kërkesave të ligjit 80/2015 studentët janë të organizuar në Këshillat Studentore, si një organizim i pavarur që promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinonjë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UST-së. Proçesi i riformatimit dhe zgjedhjes së këtyre këshillave ka filluar në vitin akademik 2021, ky proçes do të finalizohet në Janar 2022. Megjithatë studentët kanë qënë pjesë e vendimmarrjes nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese të institucionit si dhe Komisionet e Përhershme të ngritura nga SA. Bashkëpunimi dhe konsultimi me studentët është realizuar dhe në takime të rregullta me drejtuesit e UST-së, në tavolinat e rrumbullakëta tematike që janë zhvilluar me grupe studentësh. Institucioni ka tërhequr mendimin dhe vlerësimin e studentëve në përfundim të çdo semestri lidhur me cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve dhe të veprimtarisë së departamenteve duke u kërkuar të plotësojnë formularët e standardizuar. Mendimet dhe vlerësimet e studentëve janë përdorur për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, të programeve mësimore dhe të veprimtarisë së departamenteve.

Të gjitha fakultetet janë angazhuar që studentët të jenë pjesë e veprimtarive akademike, kërkimore, zhvilluese të organizuara prej tyre.

Në UST vepron edhe njësia e Alumnit, anëtarët e këtij komuniteti kontribuojnë me idetë dhe përvojën e tyre në përmirësimin e ofertës akademike dhe promovimin e UST-së.

Drejtoria që mbulon çështjet studentore e riorganizuar gjatë vitit 2020-2021 ka si mision të mbështesë pjesëmarrjen aktive të studentëve për përmbushjen e misionit të universitetit, të kryejë këshillimin për karrierë dhe të mbështesë veprimtarinë e komunitetit Alumni. Kjo njësi ka ofruar asistencë për studentët, ka organizuar pjesëmarrjen në ditët e hapura për maturantët dhe disa veprimtari për çështje sociale. Kërkohet që kjo njësi të punojë në drejtim të mbështetjes së interesave

të studentëve për t'u organizuar në klube të ndryshme të cilat mundësojnë zhvillimin e dimensionit social të veprimtarisë së studentëve.

XII. TË DHËNA PËR PLOTËSIMIN E STANDARDEVE SHTETËRORE AKADEMIKE DHE INFRASTRUKTURE

Në plotësim të standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore në përputhje me Kodin e Cilësisë, Senati Akademik në bashkëpunim me Bordin e Administrimit ka zbatuar politika të mirëfillta mbi shpërndarjen e fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë. Konkretisht, gjatë vitit akademik 2020-2021 është investuar për të përmirësuar infrastrukturën kërkimore, janë shtuar kompjuterët në funksion të mësimdhënies, është pasuruar biblioteka sipas nevojave për çdo program studimi.

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka një infrastrukturë bashkëkohore që mundëson realizimin e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe zhvilluese. Infrastruktura plotëson normat e sipërfaqes së shfrytëzueshme (16 m²/student) dhe garanton kapacitete të mjaftueshme për përmbushjen e misionit të UST-se. Kubatura e mjediseve si dhe ndriçimi natyral i plotëson normativat teknike. UST disponon Aktin Teknik për mbrojtjen nga zjarri. Godina, pas konsulencës me specialistë të zjarrit, të sigurisë së evakuimit të studentëve dhe personelit është pajisur me dyer-dalje emergjence në seksionet përbërëse të saj.

Ekzistojnë mjedise teknike që i shërbejnë godinës për ngrohje-ftohje për të siguruar vazhdimësinë normale të procesit mësimor, depozita uji me elektropompa që sigurojnë ujë të mjaftueshëm për higjienën e godinës dhe ambjenteve sportive në shërbim të saj, depo, panel elektrik.

Më poshtë do të gjeni një tabelë me të dhëna mbi infrastrukturën e UST-së për plotësimin e misionit të saj.

Tabele 20: Të dhëna për plotësimin e standarteve shtetërore infrastrukturore

Emërtimi i Institucionit të Arsimit të Lartë:

Universiteti i Sporteve

të Tiranës

GODINA	Pronesia IAL	Nr. Katesh	Siperfaqe M2	Nr. Laboratoresh	Nr. Klasa seminare (Kapaciteti ne vende)	Nr. Klasa leksione, auditore (Kapaciteti ne vende)	Biblioteka- Nr i titujve/ vende leximi	Nr. Boxe H/S per student	Akt Higjerno sanit ar Nr...	Akt Teknik Mbrojtje nga zjarri Nr....
Godina Kryesore (Palestra e fitnesit dhe gjimnastikes)	Shkresa ZQRRR nr. 17468/1 datë 13.11.2014, Çertifikatë pronësie nr. 593751	3	3344.64	7	6(214)	6(444)	1948 tituj vende leximi 48	24/	Nr.serie 0003901 date 09.05.2014	Nr.U-15883/1 date 24.06.2020
Godina dykatëshe		2	708.6		3(53)			3/		
Palestra e lojrave		2	2036.74		6(209)			17/		
Godina e re		4	2720	8	6(55)	2(250)		72/		
Ambjentet sportive jashtë			13986.76		3(60)					
Totali			22796.74	15	24(591)	8(694)				

Studentët e ciklit të parë të studimeve e zhvillojnë mesimin paradite
Studentët e ciklit të dytë të studimeve e zhvillojnë mesimin pasdite

Viti akademik 2021-2022

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes

Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit

Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit

Universiteti i Sporteve të Tiranës kanë punuar për të plotësuar të gjitha rekomandimet e raportit të akreditimit institucional duke finalizuar riakreditimin institucional me vlerësimet maksimale në të gjithë komponentët përbërës të vlerësimit.

Në bibliotekën shkencore e digjitale të UST-së ka një gamë të gjerë të literaturës në shërbim të programeve të studimit si dhe kërkimit, gjithashtu UST ka akses edhe në biblioteka dixhitale online ku gjenden të disponueshme libra dhe artikuj që kanë një orientim akademik. Universiteti i Sporteve të Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Budapestit ofron akses në literaturën online të bibliotekës së këtij Universiteti. Gjithashtu, në bashkëpunim me departamentet përkatës, studentëve iu rekomandohen vazhdimisht adresa elektronike të cilat iu duhen përgjatë studimeve dhe punës së tyre kërkimore.

Orari i punës së bibliotekës është pasqyruar në faqen zyrtare të internetit të Universitetit bashkë me mënyrën e kontaktit. Pjesë e strategjisë për përmirësimin e kushteve të bibliotekës është edhe

XIII. Të dhëna për planin buxhetor

Në zbatim të Ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH", Planin strategjik të zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës 2021-2026" të miratuar me Vendim të Senatit nr.44 datë 19.04.2021 dhe Vendim të Bordit të Administrimit nr. 31 datë 21.05.2021, Udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", Vendimi nr. 75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të IPAL dhe kërkimit shkencor", në vijim të shkresës së MASR nr. 1038 datë 15.07.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024", Programi afatmesëm 2022-2024 është hartuar mbi bazën e kërkesave të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr. 1014/3 datë 12.07.2021 "Mbi përgatitje programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 " të FVFR dhe në shkresën nr. 1073/3 datë 29.07. 2021 "Përcillet programi buxhetor afatmesëm 2022-2024" dhe të shkresës Institutit të Kërkimit Shkencor të Sporteve "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024", shkresa FSHR nr 1072 datë 28.07.2021 "Për programin buxhetor afatmesëm 2022-2024" është përgatitur Programi buxhetor afatmesëm 2022-2024 gjatë periudhës së hartimit të dokumentacionit përkatës ka patur takime në nivel njësie bazë me të gjithë aktorët përkatës.

Në hartimin e projekt buxhetit për vitin 2022 dhe PBA 2022-2024 janë patur parasysh objektivat sipas planit strategjik të miratuar .

Tabela 22 Të dhënat për planin buxhetor afatmesëm, planin njëvjeçar dhe planin strategjik

Nr.	Emertimi	Parashikimi viti 2022, në mijë lekë	Parashikimi viti 2023, në mijë lekë	Parashikimi viti 2024, në mijë lekë
1	Pagat	184656	215008	220000
2	Kontrib. e Sigurimeve Shoqerore	27472	31500	32000
3	Mallra dhe Sherbime	134212	124249	119889
4	Transfer. Korrente të Huaja	800	850	900
5	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individet	10860	11860	12360
6	Shpenzime Kapitale të Trupezuara	384338	383281	278206
7	Projekte të huaja	4336		
8	Rimbursim TVSH	420		
	Totali	747094	766748	663355
	Nr. stafit efektiv	187	190	190

Realizimi faktik i planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, plani buxhetor të vitit pasardhës akademik si dhe tarifat e shkollimit

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur realizimi faktik i planit buxhetor për vitin 2020(buxhet dhe të ardhura)

Gjatë vitit 2020-2021 duhet patur parasysh se ka qenë një periudhë pandemie covid 19 e cila ka ndikuar në realizimin e buxhetit në tërësi , pasi ishin vënë në dispozicion fonde për studentët, kërkimin shkencor etj.procesi mësimor në pjesën më të madhe të kohës ka qenë on line.

TABELA 23

Buxheti 2020

Nr	KAP	KODI PROJEKT	ART	Emërtimi	PLAN VJETOR(FINANCIM NGA GRANDI PER MESIMDHËNIEN) PER VITIN 2020	REALIZIMI PER VITIN 2020
					në lekë	në lekë
1	8	91105AA	600 0000	PAGA	174,508,620	145,005,049
2	8	91105AA	601 0000	Kontrib. e Sigurimeve Shoqerore	47,412,061	22,114,651
3	8	91105AA	602 0000	Mallra dhe Sherbime	51,664,194	28,532,313
4	8	91105AA	606 0000	Ndihma per fatkeqsi , sëmundje	310,074	190,075
5	8	91105AB	606 0000	Trasferta tek individët (Bursat)	12,048,236	6,430,014
6	2		231 0000	Projektet e huaja	797,674	

TABELA 24

Të ardhurat 2020

Nr	KAP	KODI PROJEKT	ART	Emërtimi	PLAN VJETOR	REALIZIMI PER VITIN 2020
						në lekë
1	6	91105AA	600 0000	PAGA	4,388,123	3,291,380
2	6	91105AA	601 0000	Kontrib. e Sigurimeve Shoqerore	1,188,033	416,521
3	6	91105AA	602 0000	Mallra dhe Sherbime	7,766,182.34	2,907,617
4	6	91105AA	605 0000	Transfer. Korrente te Huaja	112,546	
5	6	91105AA	606 0000	Trasferta të brendshme	511,280	364,200
6	6		231 0000	Investime	120,344,236	8,178,314
7	6		230 0000	Studim projektme	419,724	

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka hartuar dhe miratuar buxhetin në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Institucioni ndjek një politikë transparente në shpërndarjen e burimeve financiare duke respektuar rregullat e kontabilitetit.

Burimet e të ardhurave të UST-se janë:

- Granti i akorduar nga MAS
- Të ardhurat nga tarifat e studimit të studentëve.
- Te ardhura nga veprimtarite dytesore
- Financime nga projektet , Erasmus + etj

Tabela 25 - Detajimi i Grandit për mësimdhënien i ardhur nga MAS për vitin 2021

Nr	Emërtimi	Llogaria ekonomike	Kapitulli	Output Kod	Buxheti i detajuar për vitin 2021(në lekë)
1	Paga	6000000	8	91105AA	200,030,000
2	Sigurime shoqërore, shëndetsore	6010000	8	91105AA	34,000,000
3	Shërbime dhe mallra	6020000	8	91105AA	34,306,260
4	Bursa të studentëve	6060000	8	91105AB	16,097,514
					284,433,774

Tabela 26 - Plani i buxhetit për vitin 2021, i miratuar në Senat dhe në Bordin e Administrimit është i detajuar më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Art.	Grandi nga buxheti(në lekë)	Nga të ardhurat UST(në lekë)	Grandi nga projektet e huaja(në lekë)	Total Buxheti viti 2021(në lekë)
1	Pagat	600.8	229,134,666	3,000,000		232134666
2	Sigurime shoqërore	601	59,297,410	900,000		60197410
3	Shpenzime operative	602	57,438,141	9,354,730		66792871
4	Trasferime me jashtë	605	-	112,546		112546

5	Trasferime tek individët(ndihma të menjëhershme dhe dalje në pension)	606	518,904	147,080	665984
6	Bursa financiare	606	21,715,736	-	21715736
7	TVSH Pajisje Projekti Teavet	231.4	296,450		296450
	Investime				
1	Studim projektive	230	-	3,000,000	3000000
2	Projekti salla e lojrave me dorë			419,724	419724
3	Supervizion kolaudim(salla e lojrave)			728,316	728316
4	Rikonstruksione	231	-	86,063,637	86063637
5	Rikonstruksion salla e lojrave	231		33,058,895	33058895
6	Pajisje profesionale për palestrat	231	-	10,000,000	10000000
7	Pajisje laborator i vlerësimit funksional dhe rehabilitimit	231		10,000,000	10000000
8	Pajisje laborator biokimik	231	-	1,750,000	1750000
9	Pajisje laborator anatomia (viti 2020)	231		914,400	914400
10	Pajisje kompjuterike, fotokopje	231		5,000,000	5000000
11	Sistemi i dixhitalizimit	231		10,000,000	10000000
12	Pajisje zyre dhe të tjera	231		1,000,000	1000000
	Projekte të huaja				
1	Grande koherente	600-602	-	3,336,794	3336794
2	Pajisje	231	-	1,000,000	1000000

Tabela 27 - Të ardhurat e krijuara nga Universiteti i Sporteve të Tiranës si më poshtë:

Të ardhurat për vitin 2020

Nr	Emërtimi i llogarisë	Të ardhurat e krijuara për vitin 2020
1	<i>Të ardhura nga qeraja</i>	297,000
2	<i>Tarifa për rregjistrimin në arsim të lartë</i>	1,158,100
3	<i>Tarifa Shkollimi</i>	44,081,436
4	<i>Tarifa nga konkurset</i>	3,750,005
5	<i>Të tjera Tarifa Administrative dhe Rregullatore nacionale(vërtetime)</i>	24,800
6	<i>Të ardhura nga parkingu.</i>	727,100

7	<i>Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh(pjesmarrja në konferencë)</i>	38,204
8	<i>Të ardhura nga fotokopjet.</i>	212
9	<i>Shitja e shtypshkrimeve(Diplomat+Lista Note)</i>	2,058,200
10	<i>Të ardhura nga dok .tenderi</i>	-
11	<i>Të tjera nga shitja e mallrave e shërbimeve</i>	4,315,498
12	<i>Grante nga organizata ndërkombëtare</i>	-
		56,450,555

Tabela 28 - Të ardhurat për periudhen Janar - Nëntor 2021

Nr	Emërtimi i llogarisë	Të ardhurat progresive
1	<i>Të ardhura nga qeraja</i>	297,000
2	<i>Tarifa për rregjistrimin në arsim të lartë</i>	1,264,105
3	<i>Tarifa Shkollimi</i>	44,037,134
4	<i>Tarifa nga konkurset</i>	3,208,005
5	<i>Të tjera Tarifa Administrative dhe Rregullatore nacionale(vërtetime)</i>	95,100
6	<i>Të ardhura nga parkingu.</i>	631,410
9	<i>Shitja e shtypshkrimeve(Diplomat+Lista Note)</i>	664,600
11	<i>Të tjera nga shitja e mallrave e shërbimeve</i>	5,378,043
12	<i>Të tjera</i>	19,173
		55,594,570

Tabela 29 - Tarifat e shkollimit janë miratuar në Senat dhe në Bordin e Administrimit dhe janë të paraqitura më poshtë:

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes

Emërtimi i Programit cikli i parë Bachelor	Tarifa për program të parë studimi (në lekë)për vitin akademik 2020-2021	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2020-2021
Shkencat e Lëvizjes	35 000	233 916

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Profesional	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/

	120 kredite në lekë për vitin akademik 2020-2021	120 kredite në lekë për vitin akademik 2020-2021
Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetsor në Arsimin Parauniversitar	1166 (139 920)	1196 (143 520)

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Shkencor	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 120 kredite(në lekë) për vitin akademik 2020-2021	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2020-2021
Shkenca Sportive (FShL)	1750 (210000)	2125 (255 000)

Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit

Emërtimi i Programit cikli i parë Bachelor	Tarifa për program të parë studimi (në lekë)për vitin akademik 2020-2021	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2020-2021
Fushat e veprimtarisë fizike të shëndetit dhe të rekreacionit	35 000	233 916

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Profesional	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 60 kredite (në lekë) për vitin akademik 2020-2021	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 60 kredite (në lekë) për vitin akademik 2020-2021
Menaxhim në Sport dhe Turizëm	1250 (75 000)	1520 (91 200)
Aktivitet Fizik dhe Rekreacion-Trainer fitness (FVFR)	1330 (79 800)	1530 (91 800)

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Shkencor	Tarifa për kredit për program të parë studimi (në lekë)/ 120 kredite në lekë për vitin akademik 2020-2021	Tarifa për kredit për program të dytë studimi (në lekë)/ 120 kredite ne lekë për vitin akademik 2020-2021
Aktivitet Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	1750 (210 000)	2125 (255 000)

Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit

Emërtimi i Programit cikli i parë Bachelor	Tarifa për program të parë studimi (në lekë) për vitin akademik 2020-2021	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2020-2021
Fusha Shkenca të Rehabilitimit	35 000	233 916

Gjatë vitit akademik 2020-2021 në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e studentëve të cilët janë përjashtuar nga tarifa e shkollimit dhe përfitojnë bursë sipas kriterëve të përcaktuara me VKM dhe të shpallura në faqen e web

Tabela 30 :Studentët që përfitojnë përjashtim dhe ulje tarife vjetore shkollimi vitet 2020-2021

Nr	Kriteri	2020-2021	
		Nr.st	efekti financiar
Studentë ekselent			
1	Cikli I i studimeve	9	315,000
2	Cikli II i studimeve	14	611,070
	Totali për studentët ekselent	23	926,070
Studentë në nevojë			
1	Cikli I i studimeve	124	3,780,000
2	Cikli II i studimeve	32	1,146,840

	Totali për studentët ne nevojë	156	4,926,840
	Totali 1+2	179	5,852,910

Tabela 31 – Përjashtimi nga tarifa e shkollimit sipas kriterëve të përcaktuara, për vitin akademik 2020-2021

Nr	Kriteret e përjashtimit	Cikli i parë i studimeve	Cikli i dytë i studimeve
	Ekselent	9	14
1	Studentët me aftësi të kufizuar të vërtetuar me vendim KMCAP	3	2
2	Studentë fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuar të vërtetuar me vendim KMCAP për punë		15
3	Studentët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomik	71	10
4	Studentë deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, të ardhurat vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimit		3
5	Studentë që kanë përfituar statusin e jetimit deri në moshën 25 vjeç		1
6	Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të perndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie		1
7	Student me një prind pensionist dhe një prind të ndarë nga jeta	7	
8	Student, që kanë të dy prindërit pensionist	1	
9	Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç	2	
10	Ballkano egjiptian	2	
11	Student me një prind me aftësi të kufizuar	36	
12	Familje ish të perndjekur politik	2	
	Shuma Totale	133	46

Tabela 32 - Studentë që përfitojnë bursë për vitet 2020-2021

Kriteri	2020-2021	
	Nr.st	Efkti Financiar
Me rezultate të larta	9	720,000
Studentë në nevojë	84	6,162,724
Total	93	6,882,724

Dokumentacioni i shlyerjes tatimore, si dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka shlyer të gjithë detyrimet dhe nuk ka detyrime deri në këtë moment ndaj të tretëve apo ndonjë institucioni.

Më poshtë kemi nxjerrë nga e-albania vertetimet përkatëse si për tatimet dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSIME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANE

Nr. T05180606

Datë: 10.12.2021

VËRTETIM (Për pagim Detyrimesh)

Vërtetimi është:

Z./ZQJ: Agim Kasa
Tatimpaguesi: UNIVERSITETI I SPORTEVE TE TIRANES
NIPIT-i: K51712019Q
Aktiviteti: Aktivitete të administratës së përgjithshme publike
Adresat: AH HAME T GJOKESHIA, Tiranë, Tiranë

Rezultati se nuk ka asnjë detyrim tatimor të paguar deri në datën: 10.12.2021 ora 12:08:05

Ky vërtetim jepet në efekt DOKUMENTI.

Drejtuesi i Shërbimit të Tatimpaguesve



Verifikoni adresën dhe adresën
REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANE

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe validuar me soft
të siguruar nga kompania e shërbimit të informacionit dhe komunikimit
Rajonale Tiranë (Tiranë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANË

Nr. T05180513

Datë, 10.12.2021

VËRTETIM

(Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a)

Vërtetojmë se për Personin Juridik / Fizik UNIVERSITETI I SPORTEVE TE TIRANES, me numër NIPT-i K51712019Q, me përfaqësues ligjor Z/Znj. Agron Kasa, në mbështetje të deklaramëve e pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të dhënave të rubrikave të formularit "Listëpagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi", të deklaruara nga subjekti, por që akoma ndodhen në Drejtorinë Rajonale Tatimore, rezultojnë keto të dhëna:

Nr	Periudha tatimore	Numri i Kontributeve	Detyrimet(kontributet, interesat) Në lekë	Pagesat(kontributet, interesat) Në lekë
1	2111	160	4,506,981	4,506,981
2	2110	148	3,688,696	3,688,696
3	2109	147	3,601,750	3,601,750
4	2108	145	3,638,520	3,638,520
5	2107	148	3,598,552	3,598,552
6	2106	147	3,585,151	3,585,151
7	2105	152	3,555,254	3,555,254
8	2104	146	3,399,775	3,399,775
9	2103	146	3,440,845	3,440,845
10	2102	145	3,390,284	3,390,284
11	2101	144	3,326,057	3,326,057
12	2012	140	3,335,746	3,335,746
13	2011	137	3,180,087	3,180,087
14	2010	129	3,833,145	3,833,145
15	2009	132	3,180,760	3,180,760
16	2008	132	3,197,084	3,197,084
17	2007	130	3,217,755	3,217,755
18	2006	135	3,192,755	3,192,755
19	2005	136	3,212,571	3,212,571
20	2004	137	3,211,263	3,211,263
21	2003	135	3,205,889	3,205,889
22	2002	138	3,212,151	3,212,151
23	2001	138	3,253,867	3,253,867
24	1912	137	3,236,273	3,236,273
25	1911	137	3,231,837	3,231,837
26	1910	134	3,227,256	3,227,256
27	1909	130	3,090,364	3,090,364

28	1908	129	4,030,314	4,030,314
29	1907	130	3,189,282	3,189,282
30	1906	138	3,251,537	3,251,537
31	1905	139	3,220,741	3,220,741
32	1904	139	3,174,162	3,174,162
33	1903	140	3,235,397	3,235,397
34	1902	139	3,300,951	3,300,951
35	1901	140	3,219,877	3,219,877

Nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datën 10.12.2021, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datën 10.12.2021, rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 0 lekë detyrime, nga të cilat:
 Kontribute gjithsej: 0 lekë
 Kamatëvonesa për kontributet: 0 lekë
 Gjyba lidhur me kontributet: 0 lekë

Ky vërtetim lëshohet mbi të dhënat e administruara nga sistemi informatik tatimor deri më datë 10.12.2021 ora 11:59:37.

Drejtuasi i Shërbimit të Tatimpaguesve



Vitektur elektronikisht nga Drejtoria
 Rajonale Tatimore Tirane
 Data: 2021.12.10 11:59:37
 K04213019030211210115037290004

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane)

Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.

Gjatë vitit akademik 2020-2021 ka patur financim për personelin akademik dhe administrativ të financuar nga buxheti dhe projektet Erasmus +, të cilat janë detajuar në tabelën në vijim:

Tabela 33

Financime nga projekti Erasmus + TEAVET			
Nr.	Emërtimi	Nr i personave	Financimi (ne euro)
1	Personel Akademik	2	760
2	Personel Administrativ	2	760
Totali			1520
Financimi nga Erasmus + Universiteti Budapest			
Nr.	Emërtimi	Nr i personave	Financimi (ne euro)
1	Studente	2	është shtyrë për vitin 2022
2	Personel Akademik	1	1255
3	Personel Administrativ	2	2510
Totali			3765
Financime nga projekti Erasmus + EntrAL			
Nr.	Emërtimi	Nr i personave	Financimi (ne euro)
1	Personel Akademik	3	1140
2	Personel Administrativ	2	760
3	Personel Akademik	4	3840
4	Personel Administrativ	2	1920
Totali			7660
Pjesëmarrje në konferenca financuar nga UST			
Nr.	Emërtimi	Nr i personave	Financimi (ne euro)
1	Personel Akademik (Prishtine)	6	330
2	Personel Administrativ (Prishtine)	2	110
3	Personel Akademik (Kroaci)	3	1580
4	Personel Akademik (Prishtine)	2	110
5	Personel Akademik (Budapest)	3	2965
Totali			5095

Të dhëna mbi përmirsimin e infrastrukturës sipas standarteve shtetërore të cilësisë

Tabela 34

Nr	Emërtimi				Vlera në lekë
1	Vendosja e TIM për procesin online	Hapja e email për të gjithë stafin dhe studentët	Vendosja në funksion	Trajnimi i stafit akademik dhe ndihmës akademik	77,176
2	Blerja e infrastrukturës në funksion te procesit	Kamera dhe pajisje kompjuterike	Bazë materiale		911,520
3	Ndërtimi i faqes së FSHR	Mirembajtje faqesh ëeb UST,FSHL,FVFR,FSHR	permiresimi i rrjetit kompjuterik dhe ëireles		960,000
4	Pajisje kompjuterike	kompjutera , fotokopje printera	nga të ardhurat	në proces procedura	4,791,720
5	Pajisje kompjuterike(projekti Teavet)				
6	Literaturë e huaj 2020-2021	libra te huaj			1,678,862
	Pajisje laborator				
7	Pajisje laborator anatomisë		nga të ardhurat		914,400
8	Pajisje laborator fizioterapisë		nga të ardhurat	në proces procedura	9,790,500
9	Pajisje laborator		nga grandit i kërkimit shkencor	në proces procedura	18,582,000

XIV. VLERËSIME DHE REKOMANDIME TË UST PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT

UST vlerëson se marrëdhënia me MAS ka qenë institucionale, korrekte dhe relativisht e frytshme. Shënojmë angazhimin maksimal të MAR për zbatimin e legjislacionit për ushtrimin e të drejtës sipas

ligjit, për te marre titullin e pronesise te ambjenteve dhe terreneve ne dispozicion te UST-se , proces i cili ende nuk ka perfunduar

Gjithashtu, vlerësojmë edhe marrëdhënien me Qendrën e Shërbimit Arsimor (QSHA) dhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL-in). Vëmë në dukje komunikimin e efektshëm dhe profesional me ASCAL për procedurën e akreditimit institucional. Vlerësojmë se QSHA ka bërë përmirësime në procedurën e dhënies së numrit individual të matriculimit (NIM).

Nisur nga praktika e vitit akademik 2020-2021, UST paraqet rekomandimet e mëposhtme për disa problematika:

I. Ndjekja njëkohësisht e më shumë se një programi studimi nga studentët e shkëlqyer

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 97, pika 3 parashikon se studentët e shkëlqyer mund të regjistrohen njëkohësisht në më shumë se një program studimi.

Në praktikën e zbatimit të këtij neni kemi ndeshur me këto probleme:

- Asnjë akt nënligjor nuk përmban përkufizimin për termin “student i shkëlqyer” dhe procedurën për regjistrimin e studentëve të kësaj kategorie në dy programme njëkohësisht.
- Aktet nënligjore e trajtojnë këtë term vetëm përkundrejt dhënies së bursës.
- Ndjekja njëkohësisht e dy programeve të studimit me kohë të plotë nga studentët e shkëlqyer është i pamundur praktikisht, kur ngarkesa mësimore javore është 20-25 orë; kur frekuentimi i detyrueshëm është mesatarisht në masën 60-80%; kur nuk funksionon sistemi i studimit me kohë të pjesshme ose mësimi në distancë. E vetmja mundësi është që programet e studimit të ofrohen në orare të ndryshme, gje e cila nuk është gjithmone e mundur.

Duke marrë shkas nga problematika e ndeshur për zbatimin e kësaj mundësie, që ligji të marrë vlerë zbatuese, rekomandojmë sa më poshtë vijon:

- a. MAS do të duhet të nxjerrë një akt nënligjor lidhur me mundësinë e ndjekjes njëkohësisht të dy programeve të studimit, ku të përkufizojë termin “student i shkëlqyer”; të parashikojë procedurën e regjistrimit për studentët e ciklit të parë dhe studentët e ciklit të dytë; të parashikojë rregullimin e realizimit të ngarkesës mësimore dhe rregullimin financiar.
- b. Rekomandohet që të rishikohet ngarkesa javore mësimore për studentin e cila është 20-25 orë në javë duke e pakësuar ngarkesën fizike në auditor, mbi bazën e përvojave të vendeve të tjera dhe duke mbajtur parasysh përdorimin e teknologjisë për realizimin e mesimit në distancë, sidomos për lëndet me karakter teorik.
- c. Do të duhet të amendohet Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” lidhur me format e studimit, duke shtuar studimet me kohë të pjesshme dhe në distancë në mënyrë që problematikat dhe format e mesimdhënies të aplikuar gjatë periudhës së pandemisë dhe të diplomuarit gjatë kësaj periudhe të jenë të garantuara në përputhshmerinë me ligjin.

II. Hapja e programeve të reja të studimit

Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2016 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti i Sporteve të Tiranës paraqiti kërkesën për hapjen e disa programeve të reja të studimit, disa prej të cilave unike, që nuk i ofron asnjë IAL në Shqipëri. Ne nje nga seksionet e aplikimit per programme te reja studimi eshte edhe studimi i tregut.

Duke marrë shkas nga kjo UST rekomandon sa më poshtë vijon:

Do të ishte e dobishme që MAS të hartojë politikën për hapjen e programeve të reja duke mbajtur parasysh:

- a. Të ndryshojë qasjen për studimin e tregut. MAS nëpërmjet Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit të ndërmarrë vetë studimin e tregut dhe në bazë të rezultateve të studimit të tregut të përcaktojë fushat për të cilat nevojiten programe studimi. Ky ndryshim mundëson një tablo tërësore afatmesme dhe afatgjatë, lehtëson IAL-te nga një kërkesë të cilën nuk mund ta përmbushin ne menyre profesionale dhe cilesore per arsye se institucionet qendrore që zotërojnë të dhënat nuk i vene në dispozicion të IAL-ve të dhënat e tyre, të dhënat që institucionet qendrore publikojnë janë të kufizuara dhe mungojnë të dhëna publike për tregun e arsimit të lartë, sepse nuk ekziston një organizëm për statistika në arsimin e lartë. IAL-të ndeshin vështirësi në sigurimin e të dhënave. Për fushat dhe specialitetet e reja as institucionet shtetërore përkatëse nuk kanë të dhëna.
- b. Të parashikojë krijimin e një agjencie ose zyre të statistikave për arsimin e lartë, që zotëron dhe publikon të dhëna për arsimin e lartë dhe dhe shërben si burim i hapur.
- c. Të ndryshojë qasjen e paraqitjes së programeve të reja. IAL-të të konkurrojnë për programe studimi për fushat për të cilat ka nevojë tregu aktual dhe perspektiv, sipas studimit të tregut të kryer nga MAS.
- d. Të ndryshojë qasjen e vlerësimit të programeve. IAL-të të konkurrojnë duke prezantuar dhe mbrojtur para një komisioni ekspertesh programin përkatës. Programi të vlerësohet sipas kritereve të paracaktuara që bazohen në meritën, eficiencën dhe vlerën e shtuar.

III. Procedura e çregjistrimit të studentëve gjatë aplikimit për pranimet në IAL

Aktet nënligjore për procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe çregjistrimit parashikojnë vetëm një ditë për çregjistrim për raundin e parë dhe të dytë. Kjo u ka krijuar studentëve problem me vendimmarrjen. Në mënyrë që të ndihmohen studentët, të parashikohet mundësia e çregjistrimit para raundit të tretë edhe e studentëve që janë regjistruar në raundin e parë, në mënyrë që të ndihmohen studentët të zgjedhin programin që ata dëshirojnë, kur ka ende kuota te paplotësuara para raundit të tretë.

Për fondet :

MASR në zbatim të VKM ka rimbursuar efektin financiar të studentëve që përjashtohen ose ju reduktohet tarifa e shkollimit në vitin buxhetor pasardhës dhe fondet e ardhura nga MAS kanë qenë në rritje gjatë viteve në vijim.

Për vitin në vijim nevojitet të kërkohet MAS që fondet e përfituara në grand për kërkimin shkencor dhe infrastrukturën të mbarten në vitin në vijim ashtu siç mbarten grandit për mësimdhënien.

Për inventarizimin e pronave të UST, një proces i cili ka vite që është ndjekur dhe gjithë dokumentacioni përkatës pas komunikimeve me shumë institucione është pranë MASR, kërkohet mbështetja për zgjidhjen e kësaj situatë dhe përgatitjen e Projekt VKM, pasi është penguar procesi i investimeve në infrastrukturë.

Për ndryshimin e legjislacionin :

MASR, MFE dhe institucionet tjera nevojitet të trajnohet stafi përkatës i institucionit për ndryshimet në legjislacionin përkatës.

REKTORI
Prof.Dr. AGRON KASA



DHJETOR 2021